

# KRAHASIMI UKRAINË - KOSOVË NË NARRATIVAT DEZINFORMUESE TË RUSISË



Krahasimi Ukrainë-Kosovë në Narrativat dezinformuese të Ruisë

Botues:

Action for Democratic Society (ADS) / Hibrid.info

Hulumtues:

Festim Rizanaj  
Alban Zeneli

© Të gjitha të drejtat janë te rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 08/L-205 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme, apo në çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim, apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit "Narrativat Ruse për Ukrainen në Kosovë ", që mbështetet nga "TechSoup Network's Digital Activism Program". Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e "TechSoup Network's Digital Activism Program"

Prishtinë, Nëntor, 2024

# Përmbajtja

- 
- 01**      Lista e shkurtesave
- 
- 02**      Përmbledhje ekzekutive
- 
- 05**      Hyrje
- 
- 06**      Metodologjia
- 
- 07**      Narrativat dhe implikimet në dezinformim
- 
- 09**      Narrativat ruse dhe ndikimi në Ballkanin Perëndimor
- 
- 12**      **Narrativat dezinformuese ruse për Kosovën**
- 
- 19**      Kontestimi i shtetësisë së Kosovës
- 
- 23**      Kosova si shtet jo-legjitimi
- 
- 23**      Portretizimi i Kosovës si faktor destabilizues në Ballkan
-

Lufta në Kosovë (synimi për revizionimin e historisë)	25
<b>Analogjia e agresionit në Ukrainë me luftën në Kosovë</b>	<b>26</b>
Ndalja e një gjenocidi si në Kosovë	26
Pretendimet se masakra në Bucha (Ukrainë) dhe Reçak (Kosovë), të inskenuara	27
“Transplantimi i organeve” dhe “shtëpia e verdhë”	28
Pjesëmarrja e kosovarëve dhe UÇK-së në luftën e Ukrainës	29
<b>“Krahasimi” në mes statusit të Kosovës dhe Krimesë</b>	<b>30</b>
<b>Narrativa e portretizimit të rusëve dhe serbëve si viktimë</b>	<b>32</b>
Konkluzion	38



# Lista e shkurtesave

<b>RT</b>	_____	Russia Today
<b>KFOR</b>	_____	Forcat paqeruajtëse të NATO-s në Kosovë
<b>UÇK</b>	_____	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
<b>OKB</b>	_____	Organizata e Kombeve të Bashkuara
<b>BP</b>	_____	Ballkani Perëndimor
<b>SHBA</b>	_____	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
<b>BE</b>	_____	Bashkimi Evropian
<b>NATO</b>	_____	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut

# Përmbledhje ekzekutive

Rusia synon të ndikojë në Ballkanin Perëndimor përmes narrativave të caktuara, që përfshijnë kryesisht mesazhe anti-perëndimore, si ato anti-SHBA, anti-NATO dhe anti-BE, dhe duke e paraqitur kampin euro-atlantik si shkatërrues të vlerave tradicionale dhe përgjegjës për tensionet politike të rajonit. Ndërsa, ndikimi i saj në rajon, shtrihet kryesisht përmes Serbisë, duke përdorur në masë të madhe ngjarjet në Kosovë si pretekst për të ndërtuar narrativa dezinformuese.

Sipas ndarjeve teorike për narrativat, raporti sugjeron që Rusia përdor dy lloje të tyre në rajonin e Ballkanit Perëndimor: narrativat gjeopolitike, për të rritur ndikimin në rajon dhe ato identitare, për të nxitur pakënaqësinë ndaj Perëndimit të popullsisë lokale. Ndërsa, në mënyrë të veçantë lidhur me Kosovën, këto narrativa dezinformuese përfshijnë katër tema kryesore: kontestimin e shtetësisë së Kosovës, analogjinë mes pushtimit ushtarak rus në Ukrainë dhe luftës në Kosovë, krahasimin e statusit të Kosovës me Krimenë dhe portretizimin e rusëve dhe serbëve si viktima.

Kontestimi i shtetësisë së Kosovës është një nga narrativat kryesore të dezinformimit rus, ku Rusia, në kuadër të strategjisë së saj revizioniste për të sfiduar rendin ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, synon të minojë legjitimitetin e shtetësisë së Kosovës. Një pjesë e këtyre narrativave paraqet Kosovën si një "shtet mafioz" që vepron nën mbrojtjen e KFOR-it, duke sugjeruar mbështetjen e nënkuptuar të fuqive perëndimore për aktivitetet e saj të pretenduara kriminale. Për më tepër, aludohet se Kosova është e paaftë për qeverisje të qëndrueshme pa mbështetjen e Serbisë, ndërsa minimizohet ligjshmëria dhe sovraniteti i shtetit të Kosovës. Një theks i veçantë vihet në përpjekjet për revizionimin e historisë së luftës në Kosovë, ku Rusia synon të ndërtojë një version alternativ të ngjarjeve që shtrembëron krimet e kryera ndaj popullit shqiptar dhe justifikon ndërhyrjen serbe.

Rusia përdor një analogji të qëllimshme dhe pa shpjeguar rrethanat e rasteve në mes agresionit të saj në Ukrainë dhe luftës në Kosovë, duke paraqitur agresionin ushtarak në Ukrainë si një përpjekje për të ndaluar një gjenocid të ngjashëm me atë të pretenduar në Kosovë. Rusia pretendon pa fakte se masakrat si ato në Bucha (Ukrainë) dhe Reçak (Kosovë) janë të inskenuara dhe, gjithashtu, përhap mite mbi transplantime të organeve në kushte të luftës, duke u referuar edhe te ngjarjet e vitit 1999 gjatë luftës në Kosovë dhe te trafiku i organeve që pretendohet pa fakte se përfshin UÇK-në. Po ashtu, narrativi rus pretendon pa fakte se UÇK-ja mund të jetë e pranishme në Ukrainë përmes grupesh mercenarësh, ndërsa pretendon po ashtu pa mbështetje në burime të sakta për interesimin e kosovarëve për të mbrojtur Ukrainën me armë.

Narrativa dezinformuese ruse përdor krahasimin mes Krimesë dhe Kosovës për të promovuar idenë e "standardeve të dyfishta" që përdor Perëndimi dhe OKB-ja. Rusia pretendon se, ndërsa Perëndimi njohu pavarësinë e Kosovës si shprehje e vullnetit të popullit, ai refuzon të njohë vullnetin e popullit në Krime pas referendumit të mbajtur atje pavarësisht se Kosova me Krimenë nuk mund të krahasohet në asnjë pikëpamje historike apo politike. Kjo qasje synon të minojë mbështetjen ndërkombëtare për sanksionet ndaj Ruisë dhe të sfidojë legjitimitetin e mbështetjes perëndimore për Kosovën. Duke krahasuar situatat, Rusia përpiqet të justifikojë aneksimin e Krimesë dhe të vendosë në dyshim drejtësinë e rendit ndërkombëtar.

Narrativa dezinformuese ruse përqendrohet në viktimizimin e pakicës serbe në Kosovë, duke përhapur pretendime të pabaza se ajo përballet me kërcënime serioze për sigurinë dhe pronën. Ky narrativ përfshin portretizimin e pakicës serbe dhe të Kishës Ortodokse Serbe si të shtypura dhe të kërcënuara, me qëllim krijimin e një imazhi të vazhdueshëm persekutimi. Rusia përpiqet të vendosë një paralele mes pakicës serbe në veri të Kosovës dhe pakicës ruse në Donbas, duke pretenduar se serbët në Kosovë po përballen me një persekutim të ngjashëm me atë ndaj rusëve në Donbas.

Aktorët kryesorë që ndërtojnë dhe përhapin këto narrativa janë zyrtarë të lartë rusë, si presidenti Vladimir Putin, ministri i Jashtëm Sergey Lavrov dhe zëdhënësja e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova. Të njëjtat narrativa shpërndahen më pas edhe nga mediat shtetërore ruse si "Russia Today" dhe "Sputnik" në gjuhën serbe përmes artikujve mediatic. Në mediat dhe platformat sociale digjitale, këto narrativa shpërndahen kryesisht nga influencers me shumë ndjekës, sidomos në Telegram dhe platformat e tjera.

Këto narrativa shtrembërojnë faktet dhe krijojnë situata të rreme për të rritur besueshmërinë. Karakteristika kryesore e tyre është konsistenca në ndërtimin e rrëfimeve mbi situata të sajura ose fakte të shtrembëruara, me synimin për të nxit emocionet e audiencës.

Shenjestrimi kryesor i këtyre narrativave dezinformuese është komuniteti serb në Kosovë, përmes mesazheve anti-perëndimore, ndërsa disa qytetarë të tjerë të Kosovës targetohen duke e paraqitur Perëndimin si promovues të vlerave liberale dhe Rusinë si mbrojtëse të vlerave tradicionale.

Gjetjet e raportit sugjerojnë se narrativat ruse dhe serbe për Kosovën janë të ngjashme dhe nuk është e qartë se cila palë përsërit narrativat e tjetrës; megjithatë, interesat e këtyre dy shteteve janë të ndryshme, por shpesh plotësojnë njëra-tjetrën.

# Hyrje

Raporti është realizuar nga hibrid.info, një platformë kontrollit të fakteve brenda organizatës Action for Democratic Society. Qëllimi i këtij raporti është të identifikojë dhe t'i analizojë narrativat kryesore dezinformuese të Rusisë, si dhe akterët dhe qëllimet që promovojnë këto aspekte të çrregullimit informativ.

Më tej, raporti trajton identifikimin e narrativave në një kuptim teorik, duke identifikuar tri lloje kryesore: narrativat gjeopolitike, të cilat synojnë vendosjen e një rendi moral në marrëdhëniet ndërkombëtare; narrativat kombëtare-identitare, që interpretojnë çështje të rëndësishme përmes perspektivave të brendshme të një kombi; dhe narrativat politike, që shërbejnë për të arsyetuar vendimet politike brenda shteteve. Këto lloje narrativash shqyrtohen për mënyrën se si ato mund të përfshihen në dezinformim.

Në raport analizohet ndikimi i narrativave ruse në Ballkanin Perëndimor, duke përshkruar narrativat kryesore dezinformuese që Rusia ndërton për shtetet e këtij rajoni. Gjithashtu, gjetjet e raportit zbërthimin/analizën e narrativave dezinformuese ruse me theks të veçantë për Kosovën, të cilat identifikojnë katër qëllime kryesore: kontestimin e shtetësisë së Kosovës, krijimin e një analogjie mes agresionit në Ukrainë dhe luftës në Kosovë, krahasimin e statusit të Kosovës me atë të Krimesë dhe portretizimin e rusëve dhe serbëve si viktima. Kjo pjesë përfshin gjithashtu tabela që ilustron lidhjet mes narrativave dhe qëllimeve të tyre, akterët që i krijojnë dhe shpërndajnë këto narrativa, si dhe verifikimin e fakteve në lidhje me to. Në pjesën përfundimtare, raporti analizon në detaje qëllimet, akterët dhe (pa)qëndrueshmërinë e fakteve të narrativave dezinformuese ruse për Kosovën.



# Metodologjia

Metodologjia e përzgjedhjes së të dhënave dhe identifikimin e narrativave për këtë raport, konsiston në dy forma:

Të dhënat parësore përfshijnë një analizë të literaturës ekzistuese, duke përfshirë raporte dhe lajme nga grupe ekspertësh vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe publikime tjera. Krahas kësaj, janë bërë kërkime në komunikatat zyrtare të institucioneve shtetërore të Rusisë dhe mediat ruse për t'i identifikuar narrativat kryesore ndërlidhur me Kosovën. Në kuadër të kësaj janë përdorur edhe artikujt demaskues të dezinformatave dhe narrativave ruse nga platforma për kontroll të fakteve "hibrid.info". Narrativat kryesore janë përcaktuar në bazë të identifikimit të nën-narrativave (rrëfimeve më të vogla) të cilat, nëpërmjet klasifikimit të përmbajtjeve në bazë të kontekstit dhe temës që kanë pas në përmbajtje, janë kategorizuar në narrativat kryesore.

Ndërsa, të dhënat dytësore janë mbledhur gjatë intervistave shteruese me njohës të politikave ruse dhe ndikimit rus në Ballkanin Perëndimor, respektivisht në Kosovë. Intervistat janë përpiluar në formë të pyetësorëve gjysmë të strukturuar lidhur me narrativat ruse kundrejt Kosovës, përshirë këtu qëllimin dhe ndikimin e tyre në fushat e diplomacisë dhe sigurisë.

Kjo ndërthurje e të dhënave dhe burimeve parësore e dytësore siguron një kuptim të thelluar dhe më të plotë të narrativave ruse.

# Narrativat dhe implikimet në dezinformim

## Çka është narrativi?

"Narrativi", që vjen nga latinishtja "narratio," përshkruan histori që lehtësojnë kuptimin e realiteteve komplekse dhe përshatjen në një botë të ndryshueshme, duke ndikuar perceptimet dhe vendimet shoqërore më tepër përmes miteve dhe interpretimeve sesa përmes fakteve të sakta<sup>1</sup>.

Studiuesit e kësaj fushe dallojnë tri lloje narrativash<sup>2</sup>:

---

**(1) Narrativat gjeopolitike** shpjegojnë funksionimin themelor të botës përmes temave gjithëpërfshirëse, si dinamika e pushtetit, parimet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe kornizat morale të 'të mirës' dhe 'të keqes', shpesh duke përfshirë konflikte ideologjike si komunizmi kundër kapitalizmit, në një shkallë globale.

**(2) Narrativat kombëtare** të njohura si narrativa identitare, përqendrohen në historitë dhe vetë-perceptimet e shteteve, duke përmbledhur historinë, aspiratat dhe veprimet e një kombi, si dhe duke ofruar njohuri për perspektivat e brendshme dhe të jashtme, përmes ndërtimit të një identiteti dhe vizioni kolektiv të shtetit.

**(3) Narrativat politike** shpjegojnë politikat aktuale të shtetit, arsyetimin pas vendimeve, kontributet e pritshme në zhvillim, palët e interesuara, sfidat si dhe ofrojnë udhëzime për interpretimin e ngjarjeve në zhvillim, duke ofruar një kuptim kontekstual të veprimeve qeveritare dhe implikimeve të tyre.

Narrativat, me fuqinë e tyre për të thjeshtuar konceptet komplekse në forma të kuptueshme, provokojnë qëndrime dhe veprime ndaj ngjarjeve, duke ndikuar në vetëdijen kolektive përmes përsëritjes së tyre në media masive si produkte mediatike, veçanërisht në kontekste me mendim kritik të kufizuar ose mungesë të informacionit alternativ.

---

<sup>1</sup> O. Davlikanova, A. Kostenko (2023): The War of Narratives: Ukraine's Image in the Media. Friedrich-Ebert-Stiftung Office in Ukraine

<sup>2</sup> Miskimmon, A./O'Loughlin, B./ Roselle, L. (2013): Strategic Narratives. Communication Power and the New World Order. New York: Routledge (1st edition).

## Ndikimi i narrativit në dezinformim

Në një botë thellësisht të polarizuar me konfrontime politike, ekonomike dhe të sigurisë, shtetet përdorin narrativat për të formësuar imazhin e tyre dhe për të përforcuar pozicionin e tyre në skenën ndërkombëtare, duke shfrytëzuar propagandën dhe keqinformimin për të krijuar dhe mbrojtur interesat e tyre<sup>3</sup>.

Narrativat dezinformuese përbëhen nga histori të pavërteta ose pjesërisht të vërteta që synojnë të manipulojnë publikun përmes një tërësie të organizuar kronologjikisht. Këto narrativa funksionojnë si pjesë të lidhura brenda një periudhe të caktuar, duke përdorur tema të ndryshme për të forcuar rrëfimin<sup>4</sup>.

Bazuar në teoritë e trajtuara më lartë, mund të vendosen disa pikë kryesore të qëllimeve, metodave dhe funksioneve të narrativave dezinformuese. Ato janë të ndërtuara për të manipuluar audiencën duke përhapur informacion të rremë dhe duke shfrytëzuar dobësitë në ekosistemin e informacionit, si besimi i publikut në burime të caktuara dhe përhapja e shpejtë e informacionit përmes mediave sociale. Përdorimi i tyre për qëllime të ndryshme, si minimizimi i kundërshtarëve, forma e opinionit publik dhe amplifikimi i agjendave politike, mbështetet në teknika të tilla si prezantimi selektiv i fakteve, fabrikimi i informacionit dhe amplifikimi përmes rrjeteve të botëve<sup>5</sup>. Sfidat që paraqesin narrativat dezinformuese për kohezionin shoqëror, proceset demokratike dhe stabilitetin ndërkombëtar, janë të rëndësishme për t'u adresuar në nivel global. Nga kjo pikëpamje, shpeshherë narrativat dezinformuese kanë për qëllim kryesor vetëm futjen e një rrëfimi të madh në diskutimin publik për të mbjellë ose shtuar dozën e dyshimit në vlerat shoqërore e demokratike që kanë ndërtuar shoqëritë e ndryshme. Kjo shihet si një hap i parë drejt mundësisë potenciale të ndryshimit të një gjendje faktike në terren.

---

<sup>3</sup>O. Davlikanova, A. Kostenko (2023); The War of Narratives: Ukraine's Image in the Media. Friedrich-Ebert-Stiftung Office in Ukraine

<sup>4</sup>Aleksoska, Rosana & Aleksov, Darko (2023). One Year of Russian Aggression on Ukraine – Study on the Russian Propaganda, Influence and Disinformation in North Macedonia for the Period March 2022–February 2023. Citizens Association MOST/FN: Page 55.

<sup>5</sup>Botë- Shprehje që i referohet robotëve të mediave sociale, të cilët janë programe të automatizuara që përdoren për t'u përfshirë në krijim, komentim, reagimin dhe shpërndajen e përmbajtjeve në mediat sociale.

# Narrativat ruse dhe ndikimi në Ballkanin Perëndimor

Politika zyrtare ruse përdor narrativa që portretizojnë Rusinë si shpëtimtarin historik të Evropës dhe si një urë kulturore dhe diplomatike midis Lindjes dhe Perëndimit, për të forcuar ndjenjat pro-ruse dhe për të denoncuar rrejshëm Perëndimin. Këto narrativa lavdërojnë udhëheqësin rus, Putin, dhe përpiqen të justifikojnë veprimet e qeverisë ruse, duke përdorur strategji për të formuar opinionin publik dhe për të avancuar interesat ruse brenda dhe jashtë vendit. Shpesh ato përshtkruajnë kombet perëndimore si rusofobike, ndërsa portretizojnë Rusinë si viktimën e tyre, duke pohuar pretendime territoriale dhe mohuar shkeljet e ligjit ndërkombëtar për të ndikuar në opinionin publik në nivele lokale dhe globale<sup>6</sup>.

Rusia e shfrytëzon ndikimin e saj në Serbi, pastaj përmes saj shtrinë ndikimin në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Kosovë dhe vende të tjera të Ballkanit Perëndimor si një mjet strategjik për të sfiduar BE-në dhe SHBA-në. Ajo e sheh këtë si një mundësi për të përdorur rajonin në pozicione e veta gjeopolitike, duke e konsideruar ndërhyrjen në Ballkan si një kundërpeshë ndaj veprimeve perëndimore në sferën e saj të ndikimit, si në Ukrainë, Gjeorgji apo Moldavi. Për Moskën, kjo është një mënyrë për t'i kthyer Perëndimit të njëjtën qasje të ndikimit në rajone të ndjeshme<sup>7</sup>. Shtyllat kryesore të ndikimit rus në rajon janë Serbia, Republika Srpska në Bosnjë e Hercegovinë dhe Mali i Zi. Podgorica vazhdon të mbaj një qëndrim pro-ukrainas, megjithëse situata e brendshme atje është e tensionuar për shkak të forcave pro-ruse në pushtet. Përkundrazi, Serbia dhe Republika Srpska në Bosnjë dhe Hercegovinë ruajnë marrëdhënie të ngushta dhe miqësore me Federatën Ruse<sup>8</sup>.

---

<sup>6</sup> Aleksoska, Rosana & Aleksov, Darko (2023). One Year of Russian Aggression on Ukraine – Study on the Russian Propaganda, Influence and Disinformation in North Macedonia for the Period March 2022–February 2023. Citizens Association MOST/FN: fq. 55.

<sup>7</sup> Dimitar Bechev (2019): Russia's strategic interests and tools of influence in the Western Balkans. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/russia-strategic-interests-and-tools-of-influence-in-the-western-balkans/> (Qasur 10 shtator 2024)

<sup>8</sup> Kateryna Shymkevych (2024): Russia's influence in the Balkans: challenges for supporting Ukraine in countering russian armed aggression. New Geopolitics Research Network.

Interesi i Rusisë në Ballkan është të mbaj rajonin të tensionuar, duke penguar stabilizimin dhe konsolidimin e Perëndimit në këtë zonë, veçanërisht për të kufizuar ndikimin e SHBA-së dhe vendeve perëndimore. Ky është objektivi kryesor strategjik i saj në rajon.<sup>9</sup>

Rusia, duke pranuar në heshtje se e ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në BE, përpiket kohë pas kohe të tregojë praninë e saj duke shfrytëzuar lidhjet me popullsinë e krishterë ortodokse në këtë rajon.<sup>10</sup>

Në përdorimin e luftës së informacionit dhe dezinformatave, Rusia operacionalizon qasjen 4D: shkarkim, shtrembërim, shpërçendrim dhe shqetësim. Kjo qasje e prezantuar nga Ben Nimmo, përfshin shpifjen ndaj kritikëve, shtrembërimin e narrativave të padëshiruara, ridrejtimin e akuzave ndaj të tjerëve dhe frikësimin e kundërshtarëve të saj.<sup>11</sup>

Mediat e lidhura me Kremlinin përdoren për të kontrolluar raportimin brenda vendit dhe për të shpërndarë informacion jashtë vendit, duke zbatuar një strategji të quajtur "korigjim i difuzionit," për të kundërpeshuar mbulimin medial perëndimor me një perspektivë pro-ruse në rajonet ku narrativat e Rusisë mbështesin një agjendë politike më të gjerë.<sup>12</sup> Mediat ruse, si Sputnik dhe Russia Today (RT), kanë një ndikim të gjerë në Ballkanin Perëndimor, duke përhapur narrativa negative për NATO-n dhe BE-në, si dhe promovojnë Rusinë si mbrojtëse e vlerave ortodokse dhe sllave, duke luajtur një rol kyç në përhapjen e dezinformatave për të minimizuar integrimin e rajonit në NATO dhe BE.

Mediat pro-ruse kanë luajtur një rol kyç në përhapjen e dezinformatave, duke përdorë taktika të luftës informative për të ndikuar në ngjarje si anëtarësimi i Malit të Zi në NATO dhe për të shfrytëzuar ndarjet etno-politike të Bosnjës dhe Hercegovinës. Në Maqedoninë e Veriut, ato kanë synuar të ndikojnë në mosmarrëveshjen për emrin kushtetues me Greqinë dhe integrimin euroatlantik të vendit

---

<sup>9</sup>Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>10</sup>Cero, Harun. "Euroazijska I Evropska Unija: "Šizofrenost Vanjske Politike Srbije."" Al Jazeera Balkans, Al Jazeera Balkans, 16 korrik 2017.

<sup>11</sup>Josip Mandić, Darijo Klarić. (2023). Case Study of the Russian Disinformation Campaign During the War in Ukraine – Propaganda Narratives, Goals and Impacts, Vol. 1, No. 2. <https://nsf-journal.hr/online-issues/focus/id/1471>

<sup>12</sup>Stefanov, Ruslan & Vladimirov, Martin (2020). The Kremlin Playbook in Southeast Europe. Center for the Study of Democracy



Për më tepër, këto media kanë përhapur narrativa të rreme që pretendonin se NATO-ja dhe BE-ja po punonin së bashku për të ndryshuar identitetin kombëtar të Maqedonisë, duke gjykuar mosmarrëveshjet etnike në vend me pretendimin fillimisht se paqëndrueshmëria politike është rezultat i përpjekjeve të pakicës shqiptare për të ringjallur projektin e “Shqipërisë të Madhe”<sup>13</sup>.

Në Ballkanin Perëndimor, Rusia përdor metodën “whataboutism”<sup>14</sup> për të kritikuar veprimet e vendeve perëndimore ndaj pavarësisë së Kosovës, duke injoruar veprimet e saj në Krime, me qëllim të krijimit të një narrative alternative që justifikon qëndrimet e saj dhe përhapjen e dezinformimit<sup>15</sup>. Rusia e pozicionon veten si kundërshtarë të BE-së dhe mbështet çdo nismë që pengon integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE<sup>16</sup>. Rusia nuk mund të ndalojë integrimin perëndimor të Ballkanit, por ajo pengon përparimin e vendeve, krijon përçarje dhe ruan lidhjet e saj ekonomike e politike për të rritur rëndësinë e saj gjeostrategjike<sup>17</sup>. Perceptimi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës ‘poshtëruan’ Moskën gjatë luftës së Kosovës në vitin 1999 është justifikimi kryesor në angazhimin e Rusisë në rajon për të “korrigjuar gabimet e së kaluarës”<sup>18</sup>.

Rusia, përdor historinë si mjet të ndikimit politik në të gjithë botën, duke e paraqitur veten si “çlirimtare” e popujve sllavë në Ballkan nga Perandoria Osmane në shekullin e XIX-të dhe duke e përshkruar veten si mbrojtësen tradicionale të popujve ortodoksë në rajon. Kjo narrative e portretizon Perëndimin si një aktor me interesa të fshehta dhe injoron nevojat e popujve të Ballkanit, ndërsa Moska ka manipuluar këtë histori, veçanërisht në kontekstin e luftërave në ish-Jugosllavi gjatë viteve 1990<sup>19</sup>. Nëpërmjet kësaj narrative, Rusia bën orvatje të paraqitet si fuqia kryesore që çliroi kombet ortodokse të Ballkanit nga sundimi osman dhe që ka përgjegjësinë për mbrojtjen e identitetit dhe trashëgimisë kulturore ortodokse, përmes forcimit të lidhjeve kulturore dhe politike ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor përmes këtij interpretimi historik.

<sup>13</sup> Stefanov, Ruslan & Vladimirov, Martin (2020). The Kremlin Playbook in Southeast Europe. Center for the Study of Democracy.

<sup>14</sup> “Whataboutism” një praktikë e përdorur shpesh për të fajësuar vendet e tjera për veprimet e tyre.

<sup>15</sup> Giles, K. (2016) Russia’s ‘New’ Tools for Confronting the West: Continuity and Innovation in Moscow’s Exercise of Power, Chatham House – International Affairs Think Tank. Available at: <https://www.chathamhouse.org/2016/03/russias-new-tools-confronting-west-continuity-and-innovation-moscows-exercise-power> (Accessed: 28 May 2023).

<sup>16</sup> Thomas Brey, (2022): Russian Media in the Balkans: Case study: How Moscow’s propaganda influences Serbia. Fondacionin Friedrich Naumann.

<sup>17</sup> Yordan Tsalov (2020): Russian interference in North Macedonia: A View Before the Elections: <https://www.bellingcat.com/news/uk-and-europe/2020/07/04/russian-interference-in-north-macedonia-a-view-before-the-elections/> (Qasur 10 shtator 2024).

<sup>18</sup> Dimitar Bechev (2019): Russia’s strategic interests and tools of influence in the Western Balkans. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/russia-strategic-interests-and-tools-of-influence-in-the-western-balkans/> (Qasur 10 shtator 2024)

<sup>19</sup> Yehor Braïlin (2023). Orthodoxy, Liberator Russia, Kusturica. Hoë Russian propaganda operates in the Balkans. Detector Media, <https://en.detector.media/post/orthodoxy-liberator-russia-kusturica-ho-russian-propaganda-operates-in-the-balkans> (Qasur 11 shtator 2024)

Figura të njohura publike, si regjisori serb Emir Kusturica, janë shfrytëzuar nga Rusia në luftën e saj hibride, duke promovuar narrativa pro-ruse dhe duke ndikuar fuqishëm në opinionin publik në Ballkan.<sup>20</sup>

Rusia përdor “fuqinë e butë” në Ballkanin Perëndimor përmes ndërhyrjeve në politikën e brendshme dhe mbështetjes së aktivistëve nacionalistë, si dhe duke aplikuar taktika, si embargo tregtare dhe sulme kibernetike. Përveç kësaj, ajo ndërton partneritete me Serbinë dhe Republika Srpska, duke shfrytëzuar dobësitë e politikës perëndimore për të maksimizuar ndikimin e saj dhe për të siguruar aleatë që i shërbejnë interesave të saj. Në të njëjtën kohë, Rusia angazhohet në përmbyshjen e proceseve politike në rajon përmes fushatave (dez)informative dhe mbështetjes për aktorë radikalë anti-perëndimorë, siç ilustron nga përpjekjet për të bllokuar pranimin e Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në NATO.<sup>21</sup>

## **Narrativat dezinformuese ruse për Kosovën**

Edhe pse Kosova dhe Rusia nuk kanë marrëdhënie diplomatike, Kremli ka përdorur çështjen e Kosovës për të përforcuar retorikën e saj kundër Perëndimit dhe për të ndikuar në politikën e rajonit. Përmes vetos në OKB, refuzimit për të njohur Kosovë si shtet i pavarur dhe mbështetjes së Serbisë në forume ndërkombëtare, Rusia përpiqet të pengojë integrimin dhe njohjen ndërkombëtare të Kosovës. Putini, gjithashtu, shfrytëzon nacionalizmin serb për të mbajtur ndikimin e tij në rajon dhe për të krijuar sfida për NATO-n.

Sipas gjetjeve të këtij raporti, Rusia ka disa qëllime sa i përket Kosovës dhe në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë këtu destabilizimin e këtij rajoni, nxitjen e tensioneve e të konflikteve ndëretnike, si dhe zbehjen e besimit të qytetarëve të këtij rajoni në vlerat e BE-së, SHBA-së dhe Perëndimit.

“Çështja e Kosovës” është përdorur shpesh nga Kremli. Rusia, përveç tjerash, ka përdorur pa fakte rastin e Kosovës si precedent për të ndërtuar narrativa që kishin për qëllim justifikimin e veprimeve të saj në ndërhyrjet ushtarake në rajone të ndryshme të ish-Bashkimit Sovjetik.

---

<sup>20</sup> Intervistë me Yehor Braïlian, 4 tetor 2024.

<sup>21</sup> Dimitar Bechev (2019): Russia's strategic interests and tools of influence in the Western Balkans. <https://www.atlanticcouncil.org/blogs/new-atlanticist/russia-strategic-interests-and-tools-of-influence-in-the-western-balkans/> (Qasur 10 shtator 2024)

Për shkak të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe njohjes së pavarësisë së Kosovës nga shtetet perëndimore në vitin 2008, Rusia pretendonte gjoja legjitimitetin e veprimeve të saj, duke përfshirë aneksimin e Krimesë më 2014, njohjen e territoreve të kontestuara në Gjeorgji, si Abkhazia dhe Osetia e Jugut më 2008, si dhe së fundmi rajonet Donetsk dhe Luhansk në Ukrainë më 2022.<sup>22</sup> Qëllimi kryesor i Ruisë është të justifikojë agresionin kundër Ukrainës dhe të legjitimojë pretendimet për trashëgiminë historike të Kyivan Rus dhe Krimesë, me shpresën për të provuar ligjshmërinë e pushtimeve në Osetinë Jugore, Abkhazi dhe Transnistri, gjë që do t'i shërbente Putinit për të rivendosur një perandori sovjetike brenda kufijve të para vitit 1991 dhe për të krijuar një bazë ligjore për neo-kolonializmin rus, politikë që Rusia e ka ndjekur prej rënies së Bashkimit Sovjetik.<sup>23</sup>

Rusia përdor dy ngjarje për të arritur qëllimet e saj strategjike: ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë më 1999, që Kremli e përdor si justifikim për veprimet e saj në Gjeorgji dhe Ukrainë, si dhe negociatat për statusin e Kosovës në 2006-2007 të udhëhequra nga i mandatuari i OKB-së, Martti Ahtisaari, që Rusia i paraqet si precedent për të mbështetur “republikat fantome” në fqinjësinë e saj. Këto ngjarje mbeten të pranishme në narrativën ruse edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë kishte vendosur që ky rrugëtim i Kosovës tashmë është i mbyllur për rrethet e politikës vendore dhe perëndimore.<sup>24</sup> Rusia ndjek tri qëllime kryesore: fillimisht, të justifikojë agresionin ndaj Ukrainës dhe të legjitimojë pretendimet për trashëgiminë historike të Kyivan Rus dhe Krimesë, me synimin për të provuar ligjshmërinë e pushtimeve në Oseti, Abkhazi dhe Transnistri, që Putini ta përdorë si bazë për rivendosjen e perandorisë sovjetike dhe neokolonializmit rus. Së dyti, të përhapë idenë e “ruski mir” (bota ruse) dhe të mbrojë rusishtfolësit në vende të ndryshme, si një politikë neokolonialiste me bazë ideologjike. Së fundmi, të detyrojë SHBA-në dhe BE-në ta njohin fuqinë e Ruisë përmes kërcënimeve bërthamore dhe presionit për të mos e pranuar Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë në BE dhe NATO, duke ndërtuar aleanca ushtarake dhe ndikim global.<sup>25</sup>

---

22 Valur Ingimundarson. (2022). The 'Kosovo Precedent': Russia's justification of military interventions and territorial revisions in Georgia and Ukraine. LSE IDEAS . <https://www.lse.ac.uk/ideas/publications/updates/kosovo>

23 Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

24 Hoxhaj, Enver, (2022). Përplasja e madhe: Si po e lufton Rusia Kosovën dhe Ballkanin. UET Press. Fq. 68-69.

25 Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

Veprimet dhe narrativat dezinformuese të Rusisë në Ballkan janë bazuar në dobësitë e këtyre vendeve që karakterizohen nga demokracia e brishtë, mosmarrëveshjet rajonale, ankesat historike dhe mungesa e edukimit mediatik. Këto taktika ndihmojnë Rusinë të përfitojë nga situata për të avancuar interesat e saj.<sup>26</sup>

Duke pasur parasysh mbështetjen e Rusisë për nacionalizmin ekstra-territorial serb dhe makinerinë e saj të propagandës në Serbi, ndikimi informativ pro-Kremlinit në Kosovë kanalizohet kryesisht nga jashtë, përmes mediave me bazë në Serbi (përfshi shërbimet e kanaleve ruse në gjuhën serbe si ato të Sputnik Srbija dhe RT, si dhe të disa kanaleve në rrjetin social "Telegram").<sup>27</sup> Kjo e fundit ka nisur punën në Ballkan pas pushtimit të Ukrainës më 15 nëntor 2022 dhe lansimin e njoftoi me mesazhin: "We have launched RT in the Balkans. Because Kosovo is Serbia" ("Kemi nisur RT në Ballkan sepse Kosova është Serbi").<sup>28</sup> RT zgjodhi Serbinë për zyrën e saj në Ballkan për shkak të marrëdhënieve të ngushta historike mes Rusisë dhe Serbisë, të bazuara në trashëgiminë e përbashkët sllave dhe ortodokse, si dhe për shkak të kontrollit të qeverisë serbe mbi tregun mediatik që lehtëson përhapjen e propagandës.<sup>29</sup> Media shtetërore ruse i referohet serbishtes si "gjuhë e jona" me synimin për të theksuar edhe njëherë afrimin e interesave mes Rusisë dhe Serbisë.<sup>30</sup>

Narrativat ruse anti-NATO dhe anti-BE duke iu referuar ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë në vitin 1999 dhe mosnjohja e pavarësisë së saj nga Serbia, kanë forcuar ndjenjat pro-ruse në Serbi, duke e bërë Serbinë vend të hapur ndaj propagandës së Kremlinit.<sup>31</sup> Zyra e RT-së në Beograd përdor "pastrimin e informacionit" (information laundry), ku dezinformimi i paraqitur si raportim gazetaresk shpërndahet nga disa media serbe, duke përfituar nga vështirësitë financiare të mediave në rajon.<sup>32</sup>

---

<sup>26</sup> Filipova, R. (2021) 'Tackling Kremlin's Media Capture in Southeast Europe. Shared Patterns, Specific Vulnerabilities and Responses to Russian Disinformation', Center for the Study of Democracy, p. 110. Available at: [https://www.academia.edu/en/48899540/Tackling\\_Kremlins\\_Media\\_Capture](https://www.academia.edu/en/48899540/Tackling_Kremlins_Media_Capture) (Qasur 21 Gusht 2023).

<sup>27</sup> Ibid

<sup>28</sup> <https://www.rt.com/russia/566567-rt-balkan-news-portal/>

<sup>29</sup> From Russia to Serbia: How RT spreads the Kremlin's propaganda in the Balkans despite EU sanctions, (2024):<https://rsf.org/en/russia-serbia-how-rt-spreads-kremlin-s-propaganda-balkans-despite-eu-sanctions> (Qasur 10 shtator 2024).

<sup>30</sup> Brey, Thomas (2023). Russian media in the Balkans and their role in the aggression against Ukraine: Case Study, RT Balkan. Friedrich-Naumann-Stiftung für die Freiheit. fq. 21

<sup>31</sup> From Russia to Serbia: How RT spreads the Kremlin's propaganda in the Balkans despite EU sanctions, (2024):<https://rsf.org/en/russia-serbia-how-rt-spreads-kremlin-s-propaganda-balkans-despite-eu-sanctions> (Qasur 10 shtator 2024).

<sup>32</sup> From Russia to Serbia: How RT spreads the Kremlin's propaganda in the Balkans despite EU sanctions, (2024):<https://rsf.org/en/russia-serbia-how-rt-spreads-kremlin-s-propaganda-balkans-despite-eu-sanctions> (Qasur 10 shtator 2024).

Rusia manipulon vazhdimisht faktet dhe rrotullon informacionin në mënyrë të favorshme për interesat e saj, shpesh duke përhapur gënjeshtër dhe duke krijuar dokumente e histori të rreme<sup>33</sup>. Zakonisht, këto janë fakte të sajara ose të falsifikuara. Ta zëmë, propaganda ruse e justifikoi pushtimin e Ukrainës me pretendimin se popullsia rusesht-folëse po përndiqej atje. Në realitet, nuk kishte rusofobi. Kjo është një teknikë e vjetër ku agresori përpiket të paraqitet si viktimë për të justifikuar krimin e tij<sup>34</sup>.

Narrativat dezinformuese kryesisht bazohen në konsistencë, pra përsëritje të pretendimeve të pabazuara, se sa në 'faktet' që ofrohen, e që ndikon të fitojë konsistenca kundrejt faktit<sup>35</sup>. Kanalet mediatike pro-ruse promovojnë rrëfime që përfshijnë dezinformim dhe keqinterpretim të ngjarjeve historike, duke përdorur përsëritjen për të maskuar konstruktet politike pa baza faktike<sup>36</sup>.

Barriera gjuhësore vetëm e vonon, por nuk e ndalon rrjedhën e dezinformatave që fillojnë nga Serbia dhe përhapen në disa prej mediave në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Hulumtimet tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e dezinformatave në Ballkan vijnë nga Rusia dhe shpërndahen përmes ekosistemit mediatik të Serbisë. Narrativat kryesore janë anti-Perëndimore dhe u përqendruan te "denazifikimi" i Ukrainës dhe teoritë e konspiracionit lidhur me laboratorët amerikanë të armëve biologjike. Këto përmbajtje përhapen jo vetëm në mediat sociale, si Facebook dhe Instagram, por edhe në mediat tradicionale të rajonit<sup>37</sup>.

Sanksionet e fundit të SHBA-së ndaj RT pasqyrojnë një ndryshim në taktikat e Rusisë. Fokusi tani është te "krijimi i mediave të rreme 'doppelganger'<sup>38</sup> dhe sponsorimi i influencuesve në platforma, si TikTok dhe X/Twitter, shpesh nga shtetet e shënjestruara. Këto kanale amplifikojnë narrativa për bashkimin kombëtar ose kërcënimin e mundshëm të luftës në Kosovë, narrativa që mund të shfrytëzohet nga Rusia për të avancuar agjendën e saj<sup>39</sup>.

---

<sup>33</sup> Intervistë me gazetare ukrainase, 27 shtator 2024.

<sup>34</sup> Intervistë me Liudmyla Makei, 11 tetor 2024.

<sup>35</sup> Intervistë me Gynen Venhari, 4 tetor 2024.

<sup>36</sup> Intervistë me Marko Banovic, 17 tetor 2024.

<sup>37</sup> <https://birn.eu.com/wp-content/uploads/2023/07/Russian-state-sponsored-disinformation-narratives-in-Albania.pdf>

<sup>38</sup> Term që ka kuptimin e një profile në media sociale që ka për synim të ngjajë me media reale duke përdorë atributet kryesore vizuale

<sup>39</sup> Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.



Telegram është bërë popullor në Ballkan që nga pushtimi i Ukrainës, veçanërisht mes serbëve dhe në vendet ku përdoret alfabeti cirilik, ndërsa rusët kanë krijuar kanale për përdoruesit e alfabeteve latine, duke rritur propagandën në kroatisht, sllovenisht, shqip dhe greqisht.<sup>40</sup>

Rreziku rritet përmes mediave sociale, ku shpërndahet përmbajtje destruktive dhe dezinformuese pa u ditur se ajo përmbajtje është me origjinë ruse<sup>41</sup>. Agjentë të shërbimeve shtetërore ruse të inteligjencës shpërndajnë narrativa të Kremlinit në mediat sociale, me fokus të veçantë në Telegram, në platformën X dhe më pak në Facebook për shkak të mënyrës së funksionimit të algoritmeve.<sup>42</sup> Këto narrativa shpesh shtohen në sipërfaqen e ngjarjeve historike, nxitin përplasje ekzistuese në mes të grupeve etnike. Në të vërtetë, ngjarjet historike shfrytëzohen për të nxjerrë paralele mes të kaluarës dhe ngjarjeve aktuale në Ballkanin Perëndimor në lidhje me luftën në Ukrainë<sup>43</sup>. Lufta informative ruse dhe serbe kontribuon gjithashtu në nxitjen e ndjenjave anti-perëndimore në Kosovë, “duke dobësuar lidhjet tradicionale të vendit me Perëndimin,” të cilat janë thelbësore për suksesin e Kosovës në arenën ndërkombëtare. Kjo bëhet përmes kanaleve të ndryshme mediatike, “duke përfshirë fermat e gënjeshtreve/mashtrimeve (troll farm) në rrjetet sociale, për të forcuar narrativat anti-perëndimore mes shqiptarëve në Kosovë”<sup>44</sup>.

Disa subjekte politike ruse në arenën ndërkombëtare përdorin ‘retorikën krahasuese’, duke nxjerrë paralele në mes të njohjes ndërkombëtare dhe statusit të pavarësisë së Kosovës me ngjarje globale të tjera, si pushtimi i Ukrainës, duke sugjeruar se Perëndimi ka përdorur standarde të dyfishta. RT më 2022 shpërndau një video të presidentit rus Putin duke vendosur paralele ndërmjet Kosovës dhe kërkesës së tij për njohjen e regjioneve të Donetskut dhe Luhanskut si republika të pavarura, duke pretenduar se shpallja e pavarësisë së tyre pas invazionit rus në Ukrainë ishte në përputhje të plotë me ligjin ndërkombëtar.<sup>45</sup>

---

40 Kateryna Shymkevych (2024): Russia’s influence in the Balkans: challenges for supporting Ukraine in countering Russian armed aggression. New Geopolitics Research Netëork.

41 Intervistë me Milazim Krasniqi, 23 shtator 2024.

42 Intervistë me Gynen Venhari, 4 tetor 2024.

43 EUvsDisinfo (2023) Disinfo: NATO intervention in Serbia proved that depleted uranium shells are comparable to a dirty bomb, EUvsDisinfo. Available at: <https://euvsdisinfo.eu/report/natointervention-in-serbia-proved-that-depleted-uranium-shells-are-comparable-to-a-dirty-bomb> (Accessed: 31 July 2023).

44 Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.

45 [https://twitter.com/RT\\_com/status/1537832678132695042](https://twitter.com/RT_com/status/1537832678132695042) (Qasur 17 Gusht 2022).

Tutje, një raport i Parlamentit Evropian gjen se narrativat ruse luajnë në margjinat e fushatave të gjata dezinformuese të dizajnuara për të delegjitimuar shtetësinë e Kosovës, për të minuar marrëdhëniet e saj me Evropën dhe për të destabilizuar qeverisjen e saj. Narrativat kryesore në këto fushata të gjata përfshijnë: pretendimet se Kosova është një shtet mafioz, që vepron nën mbrojtjen e KFOR-it dhe kështu me mbështetjen e nënkuptuar të fuqive perëndimore; shpikje dhe/ose ekzagjerim i kërcënimeve ndaj sigurisë dhe pronës së serbëve etnikë dhe pakicave të tjera që jetojnë në Kosovë; insinuata se Kosova është e paaftë për qeverisje të qëndrueshme pa mbështetjen e Serbisë.<sup>46</sup>

Në një hulumtim të bërë nga instituti KIPRED rezultoi se Sputnik Serbia publikoi më shumë dezinformata. Përmbajtja kryesore e këtyre mediave fokusohet në reduktimin e ligjshmërisë dhe sovranitetit të Kosovës, ndryshimin e narrativave të luftës dhe krimeve të luftës në ish-Jugosllavi, zvogëlimin e besueshmërisë së angazhimit perëndimor në ndërtimin e shtetit të Kosovës dhe dialogun mes Kosovës e Serbisë, si dhe portretizimin e komunitetit serb dhe Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypur dhe të kërcënuar.<sup>47</sup> Sputniku në gjuhën serbe promovon idetë në të cilat politika e jashtme ruse paraqitet si e mirëqënë dhe publikohet për t'u kuptuar dhe miratuar, ndërsa promovohet ideja se teknologjia ushtarake ruse është superiore ndaj asaj perëndimore. Ndikimi i Ruisë mbi shtetet e Ballkanit Perëndimor synon të nxisë përçarje midis grupeve etnike, si serbët kundër kroatëve, shqiptarëve apo malazezëve. Po ashtu, Brukseli paraqitet në mënyrë negative për të penguar afrimin e këtyre shteteve me strukturat euroatlantike, ndërkohë që promovohet bashkëpunimi ekonomik me Rusinë si më i dobishëm sesa me Perëndimin.<sup>48</sup>

Sputnik Srbija përqendrohet në politikat e Ruisë dhe akterëve të tjerë ndërkombëtarë në rajon, me fokus të veçantë te Republika Srpska dhe Kosova, duke argumentuar se bashkëpunimi me Rusinë dhe Kinën është më i dobishëm për Ballkanin Perëndimor.

---

<sup>46</sup> Mapping Fake News and Disinformation in the Western Balkans and Identifying ways to Effectively Counter Them. (2021). European Parliament, fq. 26.

<sup>47</sup> [https://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo\\_Observer\\_Russian\\_Diplomatic\\_Warfare\\_and\\_Media\\_Disinformation\\_November\\_1,\\_2021\\_%E2%80%93\\_January\\_15,\\_2022\\_790580.pdf](https://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo_Observer_Russian_Diplomatic_Warfare_and_Media_Disinformation_November_1,_2021_%E2%80%93_January_15,_2022_790580.pdf)

<sup>48</sup> Brey, Thomas. (2018). Russische Medienmacht und Revisionismus in Serbien. SÜDOSTEUROPA Mitteilungen, 26–41.

Në kuadër të kësaj promovohet narrativa se Rusia e sheh rajonin si të qëndrueshëm dhe kritikon pavarësinë e Kosovës, duke e përshkruar atë si burim paqëndrueshmërie. Gjithashtu, Sputnik kritikon paaftësinë e BE-së ndaj Serbisë dhe portretizon politikën amerikane si armiqësore ndaj Serbisë dhe Rusisë, duke e quajtur Kosovën "Kosova e ashtuquajtur" dhe duke e përshkruar atë si "kancer" për rajonin, ndërsa kundërshton politikën e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, duke e parë praninë perëndimore si hegjemoni.<sup>49</sup>

Në tabelën e mëposhtme janë sqaruar tri shtylla kryesore që lidhen me narrativat dhe qëllimet në kontekstin e situatës aktuale. Shtylla e parë fokusohet në qëllimet e ndryshme që ndjekin aktorët e përfshirë, duke identifikuar arsyet dhe motivet pas qëndrimeve të tyre. Kjo ndihmon në kuptimin e asaj që ata duan të arrijnë përmes narrativave që përhapin. Shtylla e dytë merret me narrativat specifike që përdoren për të manipuluar perceptimet e publikut dhe për të arritur objektivat e caktuara, duke analizuar mënyrat se si ato reflektojnë ideologji të caktuara dhe si ndihmojnë në forcimin e ndarjeve shoqërore. Shtylla e tretë identifikon zyrtarët, mediat ose grupet e interesit që janë përgjegjës për shpërndarjen e këtyre narrativave, duke ofruar një pamje të qartë mbi kanalet e informacionit dhe ndikimin e tyre në opinionin publik. Kjo strukturë ofron një kuptim më të thellë të mënyrës se si informatat manipulojnë mendimet dhe sjelljet e njerëzve në një kontekst të caktuar.

---

<sup>49</sup> Rizanaj, Festim (2023). Uluslararası Yayincılık Bağlamında Kamu Diplomasisinde Stratejik Anlatı (Narrativat strategjike të transmetuesve ndërkombëtar në kontekst të diplomacisë publike). Nobel Yayınları. Ankara, fq. 319

Qëllimet e narrativave dezinformuese	Narrativat dezinformuese	Përballja me faktet
<p><b>Kontestimi i shtetësisë së Kosovës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kosova është një shtet mafioz, që vepron nën mbrojtjen e KFOR-it dhe kështu me mbështetjen e nënkuptuar të fuqive perëndimore</li> <li>- Insinuata se Kosova është e paaftë për qeverisje të qëndrueshme pa mbështetjen e Serbisë</li> <li>- Minimimi i ligjshmërisë dhe sovranitetit të Kosovës</li> </ul>	<p>Faktet tregojnë se këto narrativa dezinformuese janë pjesë e fushatave të gjata të dezinformimit që synojnë të delegjitimojnë shtetësinë e Kosovës, të dëmtojnë marrëdhëniet e saj me Europën dhe të destabilizojnë qeverisjen e saj.<sup>50</sup></p>
<p><b>Analogjia e agresionit në Ukrainë dhe luftës në Kosovë</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Agresioni në Ukrainë për ndaljen e një gjenocidi si në Kosovë</li> <li>- Kosova nuk duhet të krahasohet me Donbasin, pasi atje nuk ka pasur referendum.<sup>51</sup></li> <li>- Masakrat në Bucha (Ukrainë) dhe Reçak (Kosovë), të inskenuara</li> </ul>	<p>Faktet tregojnë se Kosova nuk krahasohet me rajonin e Donbasit, ndërsa masakrat në Bucha dhe Reçak kanë qenë ngjarje të vërteta dhe jo të inskenuara.<sup>52</sup> Nuk ka prova për transplantime organesh gjatë luftës në Kosovë, as në Ukrainë,<sup>53</sup> dhe UÇK-ja nuk është e përfshirë në konfliktin ukrainas,<sup>54</sup> po ashtu nuk ka interesim nga kosovarët për të marrë pjesë në këtë luftë.<sup>55</sup></p>

<sup>50</sup> [https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EXPO\\_STU\(2020\)653621](https://www.europarl.europa.eu/thinktank/en/document/EXPO_STU(2020)653621)

<sup>51</sup> <https://infomax.mk/%d0%b7%d0%b0%d1%85%d0%b0%d1%80%d0%be%d0%b2%d0%b0-%d0%bd%d0%b5-%d0%b3%d0%be-%d1%81%d0%bf%d0%be%d1%80%d0%b5%d0%b4%d1%83%d0%b2%d0%b0%d1%98%d1%82%d0%b5-%d0%ba%d0%be%d1%81%d0%be%d0%b2%d0%be-%d1%81%d0%be/>

<sup>52</sup> <https://hibrid.info/lavrov-pretendon-se-masakrat-ne-ukraine-jane-inskenuar-nje-te-sukur-ajo-e-recak-ut-ne-kosove/>

<sup>53</sup> <https://hibrid.info/krijohet-edhe-nje-pretendim-i-pabazuar-per-trafikim-organesh-ne-ukraine-synohet-te-nderlidhet-me-pretendimet-tjeter-te-pabazuar-per-shtepine-e-verdhe/>

<sup>54</sup> <https://hibrid.info/synohet-te-nderlidhet-pretendimi-i-pabazuar-per-trafikim-organesh-ne-ukraine-m-e-perfshirjen-e-uck-se/>

<sup>55</sup> <https://hibrid.info/pretendimi-i-lavrov-it-se-mercenare-nga-kosova-jane-vendosur-ne-donbas-esht-e-i-pabazuar-ne-fakte/>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Transplantime të organeve në kushte terreni të luftës, si në 1999 edhe në Ukrainë.</li> <li>- UÇK-ja është e përfshirë në trafikimin e organeve</li> <li>- UÇK mund të jetë e pranishme në Ukrainë, përmes një grupi mercenarësh.</li> <li>- Interesim nga kosovarët për ta mbrojtur me armë Ukrainën.</li> </ul>	
<p>“Krahasimi” Krime - Kosovë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Perëndimi nuk e njuh vullnetin e popullit në Krime, siç e kanë njohur Kosovën.</li> <li>- Perëndimi dhe OKB përdorin “standarde të dyfishta” në rastin e Krimesë dhe Kosovës.<sup>56</sup></li> </ul>	<p>Faktet tregojnë se krahasimi midis Kosovës dhe rajoneve të Ukrainës (Krimenë<sup>57</sup>, Donbas) të pushtuara nga Rusia është manipulativ, pasi rastet janë krejtësisht të ndryshme nga aspekti historik, ligjor dhe politik.<sup>59</sup></p>

<sup>56</sup> <https://lat.rt.rs/rusija/101513-lavrov-povelja-un-kim-krim-referendum>

<sup>57</sup> <https://hibrid.info/krahasim-dezinformues-nga-lavrov-rreth-aneksimit-te-krimese-dhe-pavaresine-e-se-kosoves/>

<sup>58</sup> <https://thegeopost.com/sq/factchecking-shq/lavrov-me-propagande-rreth-aneksimit-te-krimes-e-mundohet-te-veje-paralele-me-pavaresine-e-kosoves/>

<sup>59</sup> [https://www.kipred.org/repository/docs/KIPRED\\_-\\_Comparing\\_the\\_Incomparable\\_-\\_Kosovo\\_-\\_Russia\\_%E2%80%93\\_Ukraine\\_566569.pdf](https://www.kipred.org/repository/docs/KIPRED_-_Comparing_the_Incomparable_-_Kosovo_-_Russia_%E2%80%93_Ukraine_566569.pdf)



Portretizimi i rusëve dhe serbëve si viktimë

- Shpikje i kërcënimeve ndaj sigurisë dhe pronës së pakicës serbe dhe pakicave të tjera që jetojnë në Kosovë.

- Portretizimi i pakicës serbe dhe Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë si të shtypur dhe të kërcënuar.

- Pakica serbe që jeton në veri të Kosovës ka një rol identik si pakica ruse në Donbas.

- Persekutimi i pakicës serbe në Kosovë është i ngjashëm me persekutimin nazist të popullatës ruse nga territori i Donbasit<sup>60</sup>

Faktet tregojnë për një shpikje të kërcënimeve ndaj sigurisë së pakicës serbe,<sup>61</sup> si dhe Kishën Ortodokse Serbe,<sup>62 63</sup> duke i portretizuar si të shtypur dhe të kërcënuar, me një rol të ngjashëm me pakicën ruse në Donbas dhe duke e krahasuar persekutimin e tyre me atë nazist ndaj rusëve në Donbas.

<sup>60</sup> [https://www.facebook.com/MIDRussia/videos/3823078707935906/?\\_\\_tn\\_\\_=%2CO-R](https://www.facebook.com/MIDRussia/videos/3823078707935906/?__tn__=%2CO-R)

<sup>61</sup> <https://hibrid.info/zakharova-pretendon-pa-fakte-se-stervitja-ushtarake-defender-europe-23-n-e-kosove-perben-nje-provokim-antiserb/>

<sup>62</sup> <https://hibrid.info/politika-rs-konspiron-se-kurti-ia-ka-ofruar-vatikanit-tempujt-serbe/>

<sup>63</sup> <https://hibrid.info/narrativi-dezinformues-ruso-serb-per-sulm-te-planifikuar-ndaj-simboleve-te-or-todoksise-ne-kosove/>

## Pretendimet ruse për kontestimin e shtetësisë së Kosovës

Rusia, në kuadër të strategjisë për të sfiduar rendin ndërkombëtar pas Luftës së Ftohtë, ka si qëllim të minojë shtetësinë e Kosovës, duke tentuar ta paraqes atë si një shembull i ndërhyrjes liberale perëndimore. Putini shpesh e përdor fushatën ajrore të NATO-s në vitin 1999 mbi caqet e ushtrisë së atëhershme jugosllave e ish-Jugosllavisë, si dhe njohjen e Kosovës nga vendet perëndimore, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës më 2008, duke pretenduar të denoncojë “standardet e dyfishta perëndimore” në të drejtën ndërkombëtare.

Rusia ka luajtur një rol të rëndësishëm në parandalimin e anëtarësimit të Kosovës në UNESCO dhe INTERPOL, duke qenë gjithashtu një sponsor kryesor i fushatës së Serbisë për tërheqjen e njohjeve të shteteve që i kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Për të arritur këto qëllime, Rusia ka përdorur një gamë të gjerë instrumentesh, duke përfshirë fuqinë e vetos në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe rrjetin e saj të aleancave në organizatat ndërkombëtare.

Megjithëse ka pasur njëfarë konkurrence midis luftës së informacionit në mes rusëve dhe serbëve në vitet e fundit, “ato funksionojnë në sinkron për të dobësuar mbështetjen për Kosovën në Perëndim”, kryesisht duke shfrytëzuar ekstremet e djathta dhe të majta si platforma për dezinformatat.<sup>64</sup> Rusia nuk ka interes të drejtpërdrejtë për Kosovën, por e përdor atë si një mjet për të penguar dialogun Kosovë-Serbi të mbështetur nga BE-ja. Kjo strategji synon të parandalojë zgjidhjen e çështjes së Kosovës dhe integrimin e saj në organizatat ndërkombëtare. Për pasojë, Rusia ushtron presion edhe ndaj Serbisë për të mos pranuar ndonjë marrëveshje që mund të çojë në një zgjidhje përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë.<sup>65</sup>

---

<sup>64</sup> Maliqi, Agon (2023). Russian Information Warfare in the Balkans: How Identity and Religion are Instrumentalized in the Kosovo-Serbia Dispute.

<https://berkeleycenter.georgetown.edu/posts/russian-information-warfare-in-the-balkans-how-identity-and-religion-are-instrumentalized-in-the-kosovo-serbia-dispute> (Qasur 10 tetor 2024)

<sup>65</sup> Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.

## Narrativa dezinformuese për Kosovën si shtet jo-legjitim

Në narrativat dezinformuese ruse, Kosova përballlet me një kontestim të vazhdueshëm të sovranitetit dhe ligjshmërisë së saj si shtet. Rusët pretendojnë se ajo është një "shtet mafioz" që operon nën mbrojtjen e KFOR-it me mbështetjen e fuqive perëndimore dhe, sipas narrativës ruse, kjo hedh dyshime mbi aftësinë e saj për të arritur qeverisje të qëndrueshme.

Insinuatat e tyre se Kosova është e paaftë për të funksionuar pa mbështetje nga Serbia vetëm sa e thellojnë perceptimin negativ mbi legjitimitetin e saj, duke minimizuar kështu rëndësinë e sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. Këto narrativa përbëjnë një pengesë për zhvillimin e Kosovës si një shtet i pavarur dhe funksional.

Rusia vazhdimisht e portretizon pavarësinë e Kosovës si një akt të paligjshëm dhe të imponuar nga Perëndimi, duke e shmangur tërësisht faktin se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në opinionin e saj ka konstatuar që nuk ka pasur shkelje të ligjit ndërkombëtar në rastin e shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 2008. Gjithashtu, Kosova pretendohet të paraqitet si një "precedent i rrezikshëm," ku njohja e pavarësisë, sipas narrativës ruse, **minon normat ndërkombëtare dhe justifikon separatizmin në rajone të tjera.**

Rusia, pavarësisht se nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, mban një qasje të dyfishtë përmes Zyrës Ndërlidhëse të saj në Kosovë dhe injoron vendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që e cilëson pavarësinë e Kosovës në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.<sup>66</sup>

## Portretizimi i Kosovës si faktor destabilizues në Ballkan

Rusia shpesh e përshkruan Kosovën si një burim të vazhdueshëm të tensioneve dhe konfliktit në Ballkan, duke i bërë jehonë shqetësimeve për sigurinë e serbëve në Kosovë dhe për kriminalitetin e organizuar në rajon. Ky diskurs synon të përforcojë idenë se Kosova nuk është një shtet i qëndrueshëm dhe se Perëndimi ka dështuar në përpjekjet e tij për paqe.

---

<sup>63</sup> Yehor Brailian (2023). Orthodoxy, Liberator Russia, Kusturica. How Russian propaganda operates in the Balkans. Detector Media, <https://en.detector.media/post/orthodoxy-liberator-russia-kusturica-how-russian-propaganda-operates-in-the-balkans> (Qasur 11 shtator 2024)

Kosova është përshkruar si një qendër e rekrutimit të terroristëve, me zyrtaren ruse Maria Zakharova që e quajti atë një "bastion të terrorizmit"<sup>63</sup>. Sipas kësaj narrative dezinformuese, Ukraina përballet me një situatë më të rëndë në lidhje me terrorizmin se sa Kosova, duke sugjeruar se nivelin e kërcënimeve terroriste dhe aktivitetet e tilla janë më të përhapura dhe më të sofistikuara në Ukrainë<sup>64</sup>. Rusia promovon një narrativë që paraqet myslimanët nga Shqipëria, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina si kërcënim për përhapjen e islamizmit në Ballkan, ndërsa përpiqet të krijojë frikë dhe ndasi mes komuniteteve, duke e vendosur veten si mbrojtëse të vlerave tradicionale ortodokse përballë Perëndimit të portretizuar si shoqëri që ka braktisur krishterimin dhe vlerat familjare.<sup>65</sup>

**"Kosova, zemra e Serbisë" mund të gjendet si narrativ i përhapur në shumë kanale ruse:** ky narrativ është gjetur në shumë burime në gjuhën ruse që ende e quajnë Kosovën "Kosovë dhe Metohi", duke pretenduar se i përket Serbisë. Grafite në Mitrovicë tregojnë krimenë si pjesë të Rusisë dhe Kosovën si pjesë të Serbisë. Mediat ruse përdorin vazhdimisht terma si "e ashtuquajtura Republika e Kosovës" ose "republika e vetëshpallur" dhe madje edhe faqet e motit, si Meteor.com.ua, e shënojnë Kosovën si pjesë të Serbisë. Gjithashtu, mediat ruse dhe ato pro-ruse e përshkruajnë Kosovën si një vend të fundamentalizmit islamik, separatizmit, ekstremizmit, narko-terrorizmit dhe si një "shtet mafioz".<sup>66</sup>

Portretizimit të rremë të Kosovës shpeshherë i shtohen përshkrime si një 'vrimë e zezë kriminale' në hartën e Evropës, duke sugjeruar se ajo është një qendër ku zhvillohen aktivitete të paligjshme dhe kriminale. Ky term nënkupton se në këtë shtet ekzistojnë probleme të thella me krimin e organizuar, trafikimin e drogës dhe armëve, si dhe rekrutimin e individëve për aktivitete terroriste, duke e bërë atë një pikë të rrezikshme për stabilitetin e rajonit dhe për sigurinë e Evropës në përgjithësi<sup>67</sup>. Krahas kësaj, qëllimi i këtyre narrativave dezinformuese është krijimi i një opinioni negativ për Kosovën, Qeverinë dhe popullin e saj. Ato synojnë të bindin njerëzit se Kosova, dhe jo Serbia, është fajtorë për tensionet në rajon, duke manipuluar të vërtetën në favor të Kremlinit.<sup>68</sup>

---

<sup>63</sup> <https://lat.sputnikportal.rs/20201113/nebenzja-kosovo-je-regrutni-terroristicki-centar-1123848348.html>  
<sup>64</sup> <https://sputnikportal.rs/20240323/zaharova-ukrajina-prevazilazi-i-kosovo-u-ekstremistickom-lu-dilu-1170145414.html>

<sup>65</sup> Intervistë me Yehor Brailian, 4 tetor 2024.

<sup>66</sup> Intervistë me Makei Liudmyla, 11 tetor 2024.

<sup>67</sup> <https://lat.sputnikportal.rs/20210514/zaharova-radikalni-albanci-pretvorili-kosovo-u-kriminalnu-crnu-rupu-evrope-video-1125353733.html>

<sup>68</sup> Intervistë me Liudmyla Makei, 11 tetor 2024.

## Lufta në Kosovë (synimi për revizionimin e historisë)

Zhvillimet gjatë viteve të 90-ta të shekullit të kaluar (shekulli XX) dhe lufta në Kosovë përfaqësojnë një periudhë të rëndësishme dhe të ndërlikuar në historinë e Ballkanit, veçanërisht në kontekstin e narrativave që promovohen nga Rusia. Regjimi në Moskë e ka paraqitur veten si mbrojtës të serbëve dhe të drejtave të tyre, duke kritikuar ndërhyrjen e NATO-s në vitin 1999 si një akt agresioni dhe me pretendime se ka shkelur sovranitetin serb.

Rusia akuzon Ukrainën se vepron si terren trajnimi për NATO-n, duke sugjeruar se kjo e fundit ka vendosur baza ushtarake në territorin ukrainas dhe se NATO-ja, por edhe BE-ja po zhvillojnë operacione tokësore atje, çka ka bërë që vendet e Ballkanit të vendosin të rikthejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak<sup>69</sup>. Në simetri me këtë, kjo narrativë pretendon të paraqes bombardimet ajrore të NATO-së më 1999 si element anti-serb<sup>70</sup>.

Kjo qasje ka ndikuar në ndërtimin e një imazhi që demonizon Perëndimin dhe e paraqet Rusinë si një forcë mbrojtëse e të drejtave etnike dhe historike të popujve sllavë. Në këtë kontekst, Kosova shihet si një "precedent i rrezikshëm", ku njohja e pavarësisë së saj justifikon aspiratat separatiste në rajone të tjera, si Krimea dhe Donbasi, si dhe vë në dyshim normat ndërkombëtare.

Në këtë mënyrë, Rusia ka manipuluar narrativat historike për të forcuar pozitat e saj gjeopolitike dhe për të justifikuar aktivitetet e saj në rajon, duke kontribuar në polarizimin e mëtejshëm të situatës në Ballkan dhe në përpjekjet për të rivendosur ndikimin e saj në ish-republikat jugosllave.

Një nga pretendimet kryesore të narrativës ruse është se Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) bombardoi Jugosllavinë duke përdorur uranium të varfëruar dhe duke e paraqitur këtë veprim si një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe akt agresioni që kishte pasojat të rënda për popullatën civile. Ky "argument" është përdorur për të theksuar rreziqet e veprimeve ushtarake të Perëndimit dhe për të justifikuar kritikën ndaj tij.

---

<sup>69</sup> Kateryna Shymkevych (2024): Russia's influence in the Balkans: challenges for supporting Ukraine in countering Russian armed aggression. New Geopolitics Research Network.

<sup>70</sup> Intervistë me Gynen Venharin, 4 tetor 2024.

Gjithashtu, Rusia pretendon se Perëndimi ka mbrojtur trafikun e organeve dhe kontrabandën e armëve në Kosovë, duke e paraqitur këtë si një aspekt të errët të pasluftës në Kosovë dhe si një mënyrë për të treguar se misioni humanitar i NATO-s ishte në fakt i motivuar nga interesa të tjera. Këto narrativa kanë për qëllim të shpërndajnë dyshime mbi qëllimet e Perëndimit në rajon dhe të justifikojnë rolin e Rusisë si një aktor që mbështet stabilitetin dhe të drejtat e popujve në Ballkan.

## **Narrativa dezinformuese e analogjive të agresionit në Ukrainë me luftën në Kosovë**

Që në fillim të agresionit rus në Ukrainë më 2022, Kremli ka tentuar të krijojë narrativin e tij për të legjitimuar pushtimin ushtarak në Ukrainë, duke iu referuar shpesh luftës së Kosovës për të krijuar paralele me agresionin në Ukrainë. Zyrtarët rusë dhe mediat e afërta me pushtetin kanë bërë krahasime të paqena dhe dezinformuese, si "masakra e Buchas me atë të Reçakut, transplantim të organeve, krahasimin e Krimesë dhe Kosovës, si dhe pjesëmarrjen e grupeve nga Kosova në luftën e Ukrainës"<sup>71</sup>

## **Pretendimet për ndaljen e një gjenocidi si në Kosovë**

Pasi tanket dhe trupat ruse hynin në Ukrainë, presidenti rus, Vladimir Putin, si justifikim për pushtimin e një vendi sovran evropian përdori shpërbërjen e përgjakshme të ish-Jugosllavisë në vitet '90-ta të shekullit XX. Ai disa herë ka tërhequr një paralele të luftës së Kosovës, që ishte nxitur nga Serbia si pasojë e okupimit dhe gadishullit të Krimesë e aneksuar nga ana e Rusisë, si dhe zonave të Ukrainës lindore të aneksuara gjithashtu nga Rusia.

Pasi e kundërshtoi ashpër pavarësinë e Kosovës në çdo platformë ndërkombëtare për shumë vite, më 2014 Rusia filloi të mbështetej në atë që e quajti "precedenti i Kosovës" për të justifikuar aneksimin ushtarak të mbi njëzet për qind të territorit të Ukrainës.

---

<sup>71</sup> Rizanaj, Festim (2023). Ndërlidhja dezinformuese e agresionit rus në Ukrainë me Kosovën. <https://hibrid.info/nderlidhja-dezinformuese-e-agresionit-rus-ne-ukraine-me-kosoven/> (Qasur 22 tetor 2024).

Tre ditë para fillimit të pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt 2022, Putin njohu pavarësinë e dy rajoneve separatiste në Ukrainë, Donetsk dhe Luhansk, të njohura më mirë si Donbas.<sup>72</sup> Në fjalimin e tij të transmetuar më 24 shkurt 2022, përmes të cilit njoftoi planet ruse për të kryer një “operacion të posaçëm ushtarak”, ai parashtrroi deklaratën e luftës në pretendime të pabazuara për gjenocid.<sup>73</sup>

Presidenti rus është veçanërisht i përqëndruar në bombardimin e Serbisë nga NATO më 1999 dhe mbështetjen perëndimore për pavarësinë e Kosovës më 2008. Putin pretendon se të dyja këto procese përbëjnë një precedent kundër ligjit dhe rendit ndërkombëtar. Pavarësisht kësaj, Putin pretendon në deklaratën e tij se iu dha një justifikim për të pushtuar Ukrainën.

## **Mohimi i krimeve – pretendimet se masakra në Bucha (Ukrainë) dhe Reçak (Kosovë) janë të inskenuara**

Krahasime të paqëndrueshme janë bërë në rastin e barazimit të krimeve të agresionit rus në qytetin ukrainas të Buchas dhe krimeve serbe në fshatin Reçak të Kosovës.

Masakra në fshatin Reçak, në gjysmën e janarit të vitit 1999, me të paktën 40 civilë shqiptarë të vrarë, u pasua me bombardimin e NATO-s kundër caqeve të forcave serbe. Që nga ajo kohë e deri më sot (nëntor 2024), Beogradi pretendon se bëhej fjalë për një “inskenim”. Serbët pretendojnë se të vrarët ishin pjesëtarët e UÇK-së me rroba civile dhe jo popullatë civile, dhe kështu u falsifikua një krim lufte për të bindur NATO-n që të bënte ndërhyrje ajrore ndaj ish-Jugosllavisë.

Në mënyrë të ngjashme, në rastin e Buchas, Moska pretendoi se kufomat në rrugë ishin “aranzhuar (përgatitur)” nga pala ukrainase.

Ministri i Jashtëm rus, Sergey Lavrov, në maj dhe korrik të vitit 2022, pati deklaruar se masakrat ruse ndaj popullatës civile në qytetet ukrainase si Bucha, janë inskenim i pushtetit në Ukrainë dhe aleatëve të tyre perëndimorë. Madje pretendimet e tij kanë shkuar aq larg me konstatimin se inskenime të tilla nga perëndimorët janë bërë edhe vite më parë, duke përmendur masakrën e Reçakut në Kosovë të kryer nga forcat e Serbisë më 1999.<sup>74</sup>

---

<sup>72</sup> <https://www.slobodnaevropa.org/a/rusija-putin-ukrajina-teritorija/3171795.html>

<sup>73</sup> <https://foreignpolicy.com/2022/03/03/putin-ukraine-russia-nato-kosovo/>

<sup>74</sup> <https://lat.sputnikportal.rs/20220526/lavrov-u-buci-je-odradjena-ista-sema-kao-u-racku-1137735186.html>

Në bazë të fakteve, në Bucha është kryer masakër ndaj popullatës civile ukrainase nga ushtria ruse<sup>75</sup>. Argumentimin e kryerjes së masakrës së Reçakat nga forcat serbe e kanë bërë shumë organizata botërore për të drejtat e njeriut, duke nisur nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së<sup>76</sup>, shefi i Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë, William Walker<sup>77</sup>, që e përshkroi masakrën si krim kundër njerëzimit, “Human Rights Watch” (HRW), etj<sup>78</sup>.

## “Transplantimi i organeve” dhe “shtëpia e verdhë”

Një nga krahasimet tjera që bëhen nga zyrtarët dhe mediat ruse është edhe ndërlidhja e pretendimit të pabazë të transplantimit të organeve në Ukrainë me të ashtuquajturën “Shtëpia e verdhë” apo pretendimet e pabazuara deri tani për transplantimin e organeve në Shqipëri gjatë luftës në Kosovë.

Në kuadër të kësaj ndërlidhjeje synohet që të argumentohet pa fakte mundësia e transplantimit të organeve në Ukrainë, duke u bazuar në pretendimin tjetër të pabazuar që njihet si rasti i “Shtëpisë së Verdhë”.

Në prill të vitit 2022, zëdhënësja e Ministrisë së Jashtme të Rusisë, Maria Zakharova, synoi që pa fakte ta ndërlidh këtë duke e bërë pretendimin: nëse kishte qenë e mundur që në vitin 1999 të kryhen transplantime të organeve në kushte terreni të luftës, atëherë kjo është e mundur edhe në Ukrainë<sup>79,80</sup>.

Zakharova, në prill të vitit 2023, hodhi pretendimin tjetër të pabazuar për transplantim ilegal të organeve në Ukrainë, për ta krahasuar me një pretendim tjetër të ngjashëm, deri më tash i pakonfirmuar dhe rrjedhimisht i pavërtetë, që ndërlidhet me skenarin e “Shtëpisë së Verdhë” gjatë luftës në Kosovë. Ajo deklaroi se “transplantimi i organeve në Ukrainë kërkon vëmendje” pasi, siç shprehej ajo, “operacione të tilla ‘në terren’ kryheshin edhe nga ‘transplantologë’ të paligjshëm në fund të viteve nëntëdhjetë në Shqipëri”<sup>81,82</sup>.

<sup>75</sup> <https://www.dw.com/en/fact-check-ëhat-really-happened-in-bucha/video-61388310>

<sup>76</sup> Security council strongly condemns massacre of Kosovo albanians in southern Kosovo – <https://press.un.org/en/1999/19990119.sc6628.html>

<sup>77</sup> <https://www.washingtonpost.com/archive/politics/1999/01/23/this-time-walker-wasnt-speechless/dcef30bd-6469-4718-b56c-e6a4eee9c179/>

<sup>78</sup> <https://www.hrw.org/legacy/campaigns/kosovo98/racak.shtml>

<sup>79</sup> <https://lat.rt.rs/news/32683-zaharova-trgovina-organima-kosovo-metohija-ukrajina/>

<sup>80</sup> [https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2022&mm=04&dd=04&nav\\_category=78&nav\\_id=2134314](https://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2022&mm=04&dd=04&nav_category=78&nav_id=2134314)

<sup>81</sup> <https://lat.rt.rs/news/32683-zaharova-trgovina-organima-kosovo-metohija-ukrajina/>

<sup>82</sup> <https://lat.rt.rs/news/32683-zaharova-trgovina-organima-kosovo-metohija-ukrajina/>



Në gusht të vitit 2023, Zakharova, në një shkrim autoria I në gazetën ruse “Rossiyskaya Gazeta”, ka pretenduar pa fakte se UÇK-ja është e përfshirë, siç pretendon ajo, në trafikimin e organeve në Ukrainë. Përveç kësaj, Zakharova pretendonte se Ukraina është bërë lidere në trafikimin e organeve dhe, për më tepër, deklaronte pa fakte se ka informacione që edhe UÇK-ja është e përfshirë në të.<sup>83 84</sup>

Që nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë, Kremli zyrtar është munduar të krijoj narrativa dezinformuese duke i ndërlidh me pretendimin e paverifikuar dhe pa argumente ekzistimin e transplantimeve në Shqipëri (“Shtëpia e verdhë”) në kushte terreni gjatë luftës në Kosovë.

## Pjesëmarrja e kosovarëve dhe UÇK-së në luftën e Ukrainës

Prej nisjes së pushtimit ushtarak të Ukrainës nga Rusia, zyrtarët dhe mediat ruse kanë ngritur spekulime për pjesëmarrjen e kosovarëve në luftën e Ukrainës në mbështetje të ukrainasve. Këtë e kanë bërë zyrtarë të lartë rusë si, presidenti Putin, ministri i jashtëm, Lavrov dhe zëdhënësja e MPJ-së ruse, Maria Zakharova.

Lavrov, në shkurt të vitit 2023, ka pretenduar se Moska ka informacione se mercenarë nga Kosova, si dhe nga Shqipëria e Bosnjë dhe Hercegovina janë vendosur në rajonin e Donbasit në Ukrainë. Në anën tjetër, ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov, ka deklaruar se ka pasur interesim nga kosovarët për të udhëtuar drejt Ukrainës për të marrë pjesë në mbrojtjen e këtij shteti, por nuk përmend ndonjë rast që ndonjë qytetarë kosovarë të ketë shkuar për t’iu bashkuar kësaj ushtrie, ashtu siç pretendon Lavrov.<sup>85</sup>

Putin, në mars të vitit 2022, deklaroi se mercenarë nga rajoni i Ballkanit, saktësisht nga Kroacia, Shqipëria dhe Kosova, po marrin pjesë në luftën në Ukrainë, në mbështetje të kësaj të fundit.<sup>86</sup>

---

<sup>83</sup> <https://lat.sputnikportal.rs/20230807/zaharova-ukrajina---lider-na-crnom-trzistu-organa-za-trasplantaciju-1159574009.html#>

<sup>84</sup> <https://lat.rtr.rs/rusija/44302-zaharova-ovk-trgovina-organa/>

<sup>85</sup> <https://lat.sputnikportal.rs/20220218/vrbuju-placenike-s-kosova-iz-albanije-i-bih-za-donbas-lavrov-proveravamo-1134476350.html>

<sup>86</sup> [https://tass.com/politics/1416985?fbclid=IwAR0BtlcbzPMbJ69vLo9VC7cNE7xEXnhnf8qk9B\\_DA3hBt\\_CSEtsy8XJk0Y](https://tass.com/politics/1416985?fbclid=IwAR0BtlcbzPMbJ69vLo9VC7cNE7xEXnhnf8qk9B_DA3hBt_CSEtsy8XJk0Y)

Së fundmi, edhe Zakharova, në gusht 2023, pretendoi se UÇK-ja është ende duke funksionuar, por me një emër tjetër dhe mund të jetë e pranishme në Ukrainë, përmes një grupi mercenarësh. Sipas saj, UÇK-ja mund të jetë e përfshirë edhe në trafikimin e organeve në Ukrainë.<sup>87</sup>

Pretendimet e zyrtarëve të lartë rusë për pjesëmarrjen e grupeve nga Kosova dhe mundësinë e prezencës së UÇK-së në Ukrainë nuk janë të bazuara në fakte. Për më tepër, vite më parë, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar një ligj<sup>88</sup> që ua ndalon qytetarëve të saj të marrin pjesë në luftërat e huaja duke e paraparë këtë si një vepër penale, ndërkohë që këto pretendime të Ruisë janë demantuar nga zyrtarë shtetërorë të Kosovës.<sup>89</sup>

## “Krahasimi” në mes statusit të Kosovës dhe Krimesë

Presidenti rus, Putin, ka tërhequr një paralele tjetër ndërmjet aneksimit të Krimesë dhe pavarësimit të Kosovës nga Serbia në kuadër të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Pretendimet e Putinit të përsëritura gjatë aneksimit të Krimesë në vitin 2014 ndjekin këtë vijë: nëse ish-republikat jugosllave dhe ish-statusi kushtetues i Kosovës, si krahine autonome në kuadër të ish-Jugosllavisë, mund të pavarësoheshin me armë, atëherë pse edhe gadishulli strategjik ukrainas që hapet në Detin e Zi, si dhe “provincat separatiste” pro-ruse në Ukrainën lindore – me ndihmën e Ruisë, të mos e bëjnë një gjë të tillë? Sipas tij, Perëndimi nuk dëshiron të njohë vullnetin e popullit në Krime, siç ka bërë me rastin e Kosovës<sup>90 91</sup>. Si rezultat, propaganda e Kremlinit krijoi një mit për vetëvendosjen e rusishtfolësve në Ukrainë, duke përhapur një narrativë të rreme përmes mediave ruse dhe serbe që nga viti 2014, e cila gabimisht i paraqet Kosovën dhe Krimenë si situata identike në të drejtën humanitare ndërkombëtare.<sup>92</sup>

Rusia nuk ka ndonjë program gjeopolitik të qartë për Kosovën, por e përdor Kosovën si një precedent diplomatik. Ata përmendin rastin e Kosovës në diskutimet ndërkombëtare për të justifikuar veprimet e tyre në vende, si Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina duke thënë: “Nëse Kosova e bëri, pse të mos ketë edhe Krimea të drejtën të veprojë njësoj?”<sup>93</sup>. Kështu, Rusia (keq)përdor rastin e Kosovës për të mbështetur pretendimet e saj në çështje të tjera territoriale. Pra, qasja e Ruisë më shumë është “ndaj Kosovës se sa në Kosovë”<sup>94</sup>.

<sup>87</sup> <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10763>

<sup>88</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=MPdoL3sYGf8>

<sup>89</sup> <https://www.telegraf.rs/vesti/2346859-putin-zagrameo-zapad-na-kosovu-priznaje-volju-naroda-na-krimu-ne>

<sup>90</sup> <https://www.danas.rs/svet/putin-moze-kosovo-a-ne-i-krim/>

<sup>91</sup> Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

<sup>92</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>93</sup> Intervistë me Jeta Loshaj, 14 tetor 2024.

Përkundër faktit që Rusia ka aneksuar në mënyrë të paligjshme gadishullin ukrainas të Krimesë në vitin 2014 dhe që nga ajo kohë ka nisur mbështetjen për një lëvizje separatiste, Putin ka kërkuar që aneksimi i Krimesë të njihet si reflektim legjitim i zgjedhjes së banorëve lokalë<sup>95</sup>. Narrativa të tilla që bëjnë krahasime dhe që përpiqen të shfajësohen me një kundërakuzë, përdoren shumë nga Rusia, sidomos në rastin me Kosovën, kur e krahasojnë me rajonet separatiste në Ukrainë, e që ndërlihet me tekniken “whataboutism”<sup>96</sup>.

## Pse nuk qëndron krahasimi?<sup>97</sup>

NATO nuk e “pushtoi” Kosovën pas marrëveshjes për largimin e forcave serbe nga atje, por dërgoi një mision paqeruajtës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë për të gjithë qytetarët në Kosovë pa asnjë dallim, përfshirë qytetarët serbë në Kosovë. Trupat ruse, nga ana tjetër, kanë vendosur kontrollin mbi Krimenë, edhe para se të mbahej një referendum për bashkimin me Rusinë.

NATO ndërhyri në Kosovë pas dëshmimeve të krimeve serbe kundër shqiptarëve, të cilat përfshinin vrasje masive, spastrim etnik dhe dëbime nga vendbanimet e tyre. Forcat ruse kanë ndërhyrë në Ukrainë, megjithëse nuk janë raportuar abuzime apo dhunë kundë pakicës ruse.

Kosova shpalli pavarësinë, por nuk iu bashkua Shqipërisë. Krimea, e cila është e banuar kryesisht nga qytetarë rusë, nënshkroi një marrëveshje për t’u bashkuar me Rusinë dy ditë pas një referendumi që Perëndimi e gjykoi si jodemokratik<sup>98</sup>.

Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008, pas një procesi të gjatë të njohur si negociatat e Vjenës.<sup>99</sup> Në vitin 2010, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND) vlerësoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.<sup>100</sup> Pavarësia e Kosovës deri më tani është njohur nga mbi 100 shtete, përfshirë SHBA-në dhe shumica e vendeve të Bashkimit Evropian dhe vendeve tjera<sup>101</sup>.

<sup>95</sup> <https://www.evropaelire.org/a/putin-njohja-e-krimese-kosova-/3171725.html>

<sup>96</sup> Whataboutism ose whataboutery (si në “po për ...?”) është një teknikë strategjike e përgjigjes ndaj një akuzë me një kundërakuzë në vend të një mbrojtjeje kundër akuzës origjinale.

<sup>97</sup> <https://www.evropaelire.org/a/putin-njohja-e-krimese-kosova-/3171725.html>

<sup>98</sup> <https://www.glasamerike.net/a/6471431.html>

<sup>99</sup> <https://www.dw.com/sq/viti-2008-viti-i-pavar%C3%ABsis%C3%AB-s%C3%AB-kosov%C3%ABs/a-3900406>

<sup>100</sup> <https://www.dw.com/sq/gjnd-pavar%C3%ABsia-e-kosov%C3%ABs-%C3%ABsht%C3%AB-n%C3%AB-p%C3%ABrputhje-me-t%C3%AB-drejt%C3%ABn-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtare/a-5826936>

<sup>101</sup> <https://www.kosovothanksyou.com/>

Për më tepër, Krimea është pjesë integrale e shtetit të Ukrainës, e cila është aneksuar në mënyrë ilegale nga Rusia në vitin 2014. Referendumi në Krime, i mbajtur më 16 mars 2014,<sup>102</sup> u refuzua në të njëjtin vit si i paligjshëm – me votat e 100 vendeve anëtare të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së.<sup>103</sup>

Edhe pse krahasimi i Krimesë me Kosovën është i pabazë, i pavërtetë dhe i paqëndrueshëm, zyrtarët të lartë të Ruisë vazhdojnë ta përdorin këtë si alibi, duke filluar nga presidenti, Vladimir Putin, ministri i Punëve të Jashtme, Sergey Lavrov etj.<sup>104 105</sup>

## Narrativa e portretizimit të rusëve dhe serbëve si viktimë

Rusia, si aleati kryesor i Serbisë, ka shfrytëzuar këtë mundësi për të kundërshtuar pozicionet e mbështetura nga Perëndimi lidhur me Kosovën dhe ka tentuar të ndikojë në dialogun Kosovë-Serbi. Disa media në Serbi dhe në veriun e Kosovës (i banuar kryesisht nga pakica serbe), të identifikuar si të afërta me pushtetin, shtynjë përpara propagandën e njohur ruse që portretizon Serbinë si viktimë dhe vënë në dyshim legjitimitetin e shtetësisë së Kosovës. Këto publikime vënë në funksion narrativat e rishikimit historik dhe pretendimet e pavërteta për spastrim etnik të serbëve në Kosovë për të thelluar përçarjet dhe penguar dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian për arritjen e marrëveshjes përfundimtare mes Kosovës dhe Serbisë.

Makina propagandistike e Moskës është një mjet i fuqishëm për të ruajtur popullaritetin e Ruisë midis grupeve të cenushme dhe ka qenë e dobishme për politikanë si presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, duke ndjekur shembullin e diktatorit serb, Millosheviq, nga lufta e Kosovës në vitin 1999 deri te lufta aktuale në Ukrainë. Ashtu si Millosheviqi pretendoi se serbët në Kosovë ishin të shtypur nga shqiptarët, Putini ka përdorur imazhin e supozuar të rusëve të shtypur në Ukrainë për të justifikuar luftën, ndërsa Vuçiq manipulon serbët e Kosovës për të shkaktuar tensione në Kosovë përmes formave të ndryshme në orvatje për t'i paraqitur serbët si viktimë.<sup>106</sup> Një nga mjetet më efektive që Serbia përdor është manipulimi emocional, kryesisht përmes portretizimit të pakicës serbe si viktimë e vendimeve të bashkësisë ndërkombëtare dhe Ruisë si mbrojtëse e të drejtave të pakicës serbe në Kosovë.<sup>107</sup>

<sup>102</sup> <https://www.britannica.com/place/Ukraine/The-crisis-in-Crimea-and-eastern-Ukraine>

<sup>103</sup> <https://news.un.org/en/story/2014/03/464812-backing-ukraines-territorial-integrity-un-assembly-declares-crimea-referendum>

<sup>104</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=5IPBYzKR2U>

<sup>105</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=sPVuCYVtFc0>

<sup>106</sup> Ibid.

<sup>107</sup> Intervistë me Marko Banovic, 17 tetor 2024.

Ministri i Jashtëm rus, Lavrov, në shtator të vitit 2024, gjatë një takimi të Akademisë Diplomatike të MPJ-së së Rusisë, para ambasadorëve nga rreth 80 vende, deklaroi se “persekutimi i serbëve në Kosovë është i ngjashëm me persekutimin nazist të popullatës ruse nga territori i Donbasit, që u krye nga autoritetet ukrainase”<sup>108</sup>.

Yje gjashtëkëndëshe, të ngjashme me yllin e Davidit, simbolit hebre, u vendosën në telat me gjemba të KFOR-it që rrethuan<sup>109</sup> Komunën e Leposaviqit, në një situatë, ku serbët lokalë protestonin kundër kryetarit shqiptar të kësaj komune. Ky simbol, u përdor për të përçuar narrativën e rreme ruse deri në Leposaviq, meqë në vazhdimësi, presidenti rus, i është referuar qeverisë ukrainase si qeveri naziste. Tashmë ishte radha që një portretizim të tillë të tentonin ta bënin zyrtarët serb për Qeverinë e Kosovës dhe zyrtarët lokalë. Duke e promovuar këtë narrativ të rremë dhe me tendencën për të krahasuar qytetarët serbë të Kosovës me hebrenjtë gjatë Luftës së Dytë Botërore, politikanë dhe zyrtarë serbë kanë ngritur narrativa të tilla duke i keqinterpretuar faktet dhe duke vënë kontekste të rreme. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe kryetarët shqiptarë të komunave veriore të Kosovës synojnë të paraqiteshin si nazistë nga zyrtarët serbë<sup>110</sup> duke iu referuar me emërtimin “Gauleiter”<sup>111</sup> në raportimet mediale të disa mediave serbe. Portretizimi i rremë i Qeverisë së Ukrainës dhe asaj të Kosovës me nazizmin u bë e qartë edhe kur zëdhënësja e MPJ-së ruse, Zakharova, pretendoi se presidenti ukrainas, Zelenskyy dhe kryeministri i Kosovës, Kurti, janë nazistë<sup>112</sup>. Narrativat që portretizojnë Kosovën si një shtet jo të legjitimuar dhe pa perspektivë ndërkombëtare shpesh ngërthejnë në vete ide të rrezikshme.

Kosova është një shembull i qartë në të cilin tentohet të aplikohen taktikat hibride ruse, të ngjashme me ato të përdorura në Donbas nga Rusia. Përhapja e propagandës mediatike që thekson rrezikun për serbët në Kosovë, rritja e tensioneve ndëretnike në rajon dhe fushata e grafiteve me mesazhin “Kur ushtria kthehet në Kosovë”<sup>113</sup> reflektojnë zbatimin e doktrinës ruse<sup>114</sup>.

---

<sup>108</sup> <https://lat.rt.rs/rusija/108242-lavrov-srbija-kim-progon-srpski-narod-ruski-narod-donbas/>

<sup>109</sup> <https://www.youtube.com/watch?v=SgE6KeQoJug>

<sup>110</sup> <https://www.kosovo-online.com/vesti/politika/petkovic-za-sve-sto-se-juce-desilo-na-severu-kos-ova-odgovornost-snosi-aljbin-kurti>

<sup>111</sup> Gauleiter – emërtim për guvernatorët lokal nën qeverisjen naziste të Hitlerit.

<sup>112</sup> <https://happytv.rs/vesti/politika/okupacioni-gaulajter-uvodi-specijalnu-policijsku-jedinicu-za-oblac-enje-srpska-lista-upozorava-na-fasisticki-potez-aljbina-kurtija/630832/>

<sup>113</sup> <https://t.me/MFARussia/14515>

<sup>114</sup> <https://www.koha.net/arberi/kur-ushtria-te-kthehet-ne-kosove-shfaqen-grafite-te-reja-ne-veri>  
Doktrina Gerasimov, <https://www.politico.com/magazine/story/2017/09/05/gerasimov-doctrine-russia-foreign-policy-215538/>: Valery Gerasimov, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Federatës Ruse, pas të cilit është emëruar doktrina, thotë: luftërat nuk shpallen më dhe kur ato fillojnë, ato zhvillohen sipas një modeli atipik.

Sulmi terrorist në fshatin Banjskë të Zveçanit me 24 shtator 2023, që përfshinte përgatitjen mediatike dhe vetë aktin e sulmit, mbart të gjitha karakteristikat e taktikave hibride të luftës sipas kësaj doktrine.<sup>115</sup>

Rusia ka pasur një interes të veçantë për të destabilizuar situatën në Kosovë. Ajo ka synuar "nxitjen e alarmeve për luftë, nxitjen e urrejtjes ndëretnike" dhe rritjen e mosbesimit të Kosovës ndaj Perëndimit. Për më tepër, Rusia ka punuar për "sabotimin e çdo marrëveshjeje me Serbinë në ndërmjetësimin e BE-së dhe SHBA-së", duke tentuar të minojë përpjekjet për paqe dhe stabilitet në rajon.<sup>116</sup> Rusia pretendon se serbët janë viktima të propagandës perëndimore dhe se Serbia e humbi Kosovën si pasojë e kësaj propagande dhe ndërhyrjeve perëndimore.<sup>117</sup>

Formimi i një konflikti të mundshëm u iniciua me krijimin e një krize artificiale për shkak të pretendimit për kërcënimin e serbëve në Kosovë dhe krijimit të pretekstit për përshkallëzimin e konfliktit. Kjo narrativë pretendon se pakica serbe që jeton në veri të Kosovës ka një rol identik si minoriteti rus në Donbas. Përveç shkrimit të grafiteve, ishin mjaft të qarta edhe deklaratat e zyrtarëve serbë që akuzonin institucionet shtetërore të Kosovës se dëshironin një "pogrom"<sup>118</sup> të serbëve, madje edhe gjenocid. Ashtu siç ndodhi në Donbas në vitin 2014, narrativat e mediave të kontrolluara nga Rusia dhe Serbia shërbyen për të krijuar kushte informative që nxisin dhunën. Përdorimi i grupeve kriminale dhe formacioneve paraushtarake karakteristike për aksionin hibrid është përdorur këtë herë në Kosovë. Nënkryetari i Listës Serbe nga Kosova, Milan Radoičiq, i afërt me presidentin serb, Vuçiq, me një grup të armatosur rëndë ka tentuar të pushtojë fillimisht fshatin e Banjskës në veri të Kosovës. Sasia dhe lloji i armatimit, sistemet e bllokimit elektronik, minat kundër personelit, granatahedhësit automatikë dhe sasitë e mëdha të eksplozivëve<sup>119</sup> në mënyrë të papërmbajtshme kujtojnë "njerëzit e vegjël të gjelbër" ("little green men")<sup>120</sup> të Putinit, të cilët, nën maskën e luftëtarëve për lirinë e Krimesë, kryen veprimet separatiste në territorin e Ukrainës gjatë vitit 2014.

Pas sulmit terrorist në Banjskë, në shtator të vitit 2023, ku një grup serb i armatosur rëndë vrau një polic të Kosovës dhe u futën në Manastirin e Banjskës, narrativa zyrtare e Serbisë për këtë ngjarje pretendonte në mënyrë të rreme se ky ishte një "rebelim i serbëve lokalë" kundër Qeverisë së Kosovës të udhëhequr nga kryeministri Kurti.

<sup>115</sup> Azra Karastanović (Ed), (2023). IGRA U SJENKAMA – Ruske hibridne aktivnosti na Zapadnom Balkanu, Digitalni forenzički centar (DFC), Podgorica, fq. 21–22.

<sup>116</sup> Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.

<sup>117</sup> Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

<sup>118</sup> Termi që përdoret nga zyrtarët serb duke pretenduar dëbimin, spastrimin e serbëve nga Kosova.

<sup>119</sup> <https://www.evropaelire.org/a/cfare-dihet-per-armatimin-e-konfiskuar-ne-veri/32965720.html>

<sup>120</sup> <https://www.bbc.com/news/world-europe-26532154>

Madje, duke ndjekur këtë narrativë të rreme, presidenti serb, Vuçiq, kishte deklaruar në disa raste se sulmi terrorist në Banjškë është bërë nga individë që janë serbë lokalë.<sup>121</sup>

Të njëjtën narrativë e përdori Rusia pas ndërhyrjes në Krime të Ukrainës, më 2014. Në një deklaratë të ministrit të Jashtëm rus, Sergey Lavrov, ushtarët me uniforma të gjelbra, por pa logo e emblema, u quajtën qytetarë që në vetëmbrojtje kishin marrë nën kontroll zyrat administrative në gadishullin e Krimesë.<sup>122</sup>

Ndërsa, për ngjashmërinë e uniformave gjelbër me ato të ushtrisë ruse, Putini<sup>123</sup> pas aneksimit të Krimesë më 2014, kishte deklaruar se ato mund të blihen në secilën dyqan, njëjtë sikurse nëntë vite më vonë do të deklaronte Vuçiq (2023)<sup>124</sup>, për rastin e sulmuesve të Banjškës. Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, kanë mbetur dy konflikte të njohura: Transnistria në Moldavi, ku Rusia ka dërguar trupa ushtarake dhe Nagorno-Karabakh mes Armenisë dhe Azerbajxhanit.

Modeli i veprimit është i njëjtë në rastet e Serbisë dhe Ruisë. Të dyja përdorin metoda të ngjashme, duke trajnuar dhe armatosur njerëz lokalë për të realizuar qëllimet e tyre. Dilema kryesore mbetet nëse Rusia ka më shumë ndikim në Serbi apo anasjelltas.<sup>125</sup>

Megjithatë, narrativë e rreme e Ruisë kundër presidentit ukrainas, Zelenskyy, si një udhëheqës nazist në Ukrainë duket që s'është e vetmja që politikanët serbë i përdorin duke u munduar t'i shtyjnë si narrativa të Serbisë për Kosovën. Të dhënat publike deri tani nuk ofrojnë mundësi që të sqarojnë se cila nga narrativat e rreme është përdor më përpara, ato të Ruisë për Ukrainën, apo të Serbisë për Kosovën.

Këto narrativa vazhdimisht i atribuojnë popullit serb rolin e viktimës për të justifikuar dhe maskuar veprimet e forcave paramilitare, policore dhe ushtarake serbe në Kosovë, veçanërisht gjatë luftës në Kosovë dhe ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999.<sup>126</sup> Pas liberalizimit të vizave për Kosovën nga ana e BE-së ka filluar të strukturohet narrativa se qëllimi është spastrimi etnik i serbëve nëpërmjet procesit të liberalizimit të vizave, pasi që po krijohen kushte për largimin e tyre.<sup>127</sup>

---

<sup>121</sup> <https://www.aa.com.tr/en/europe/armed-individuals-eho-attacked-kosovar-police-are-local-kosovo-serbs-serbian-president/3000034>

<sup>122</sup> <https://www.rferl.org/a/russia-ukraine-crimea/29790037.html>

<sup>123</sup> <https://www.rferl.org/a/russia-ukraine-crimea/29790037.html>

<sup>124</sup> <https://apnews.com/article/kosovo-serbia-policeman-killed-tension-kurti-vucic-51a29a3159646ec020851b3b5a24836f>

<sup>125</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>126</sup> Intervistë me Marko Banovic, 17 tetor 2024.

<sup>127</sup> Intervistë me Gynen Venharin, 4 tetor 2024.

Rusia dhe Serbia ndajnë disa faktorë të ngjashëm, si ideologjia shoviniste ndaj kombeve fqinje dhe përpjekjet për të promovuar imperializmin dhe kolonializmin përmes propagandës, duke synuar të kontrollojnë territore që i konsiderojnë pjesë të trashëgimisë së tyre. Për Rusinë, këto territore përfshijnë Ukrainën, Krimenë, Bjellorusinë, shtetet baltike dhe disa vende të Azisë Qendrore; për Serbinë, Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Kosovën dhe disa territore të tjera. Një tjetër element i përbashkët është përdorimi i narrativave historike dhe shpirtërore, ku Kosova për Serbinë dhe Krimea për Rusinë shihen si qendra të lashta dhe të shenjta. Të dyja vendet përhapin idenë e zgjedhjes hyjnore dhe superioritetit ortodoks, duke promovuar gjuhën dhe kulturën e tyre si thelbësore – rusët duke e parë ukrainishten dhe bjellorusishten si dialekte të rusishtes, ndërsa serbët duke pretenduar se kroatishtja dhe malazezishja janë pjesë e gjuhës serbe. Këta faktorë ndërtojnë thelbin e ideologjive "ruski mir" (bota ruse) dhe "srpski svijet" (bota serbe).<sup>128</sup>

Narrativat ruse, të ndara dhe të strukturuar, përfshijnë argumente gjeopolitike që përdoren për të justifikuar veprimet e Rusisë, si krahasimi mes Kosovës dhe Krimesë. Këto narrativa janë të shënjestruar për të ndikuar në segmentet e ekstremit të djathtë dhe të majtë në Perëndim, ku për të djathtën propagandohet ideja e "teorisë së zëvendësimit"<sup>129</sup> për Kosovën, ndërsa për të majtën paraqitet si produkt i kolonializmit amerikan.<sup>130</sup> Në arenën diplomatike, këto narrativa kanë potencialin të ndikojnë në vendimmarrjet e shteteve skeptike të BE-së, duke portretizuar Kosovën si një vend të paqëndrueshëm.<sup>131</sup> Megjithatë, ndikimi i Rusisë në Kosovë është relativisht i vogël, ndonëse ka nxitur tensione ndëretnike dhe ka penguar dialogun me Serbinë.<sup>132</sup> Patriarku rus dhe Kisha Ortodokse Ruse janë mjetet më të fuqishme të regjimit të Kremlinit dhe propagandës së Putinit.<sup>133</sup> Megjithatë, ndikimi i Rusisë në Kosovë është relativisht i vogël, ndonëse ka nxitur tensione ndëretnike dhe ka penguar dialogun me Serbinë.<sup>134</sup> Popullsia serbe në Kosovë është shënjestra kryesore e këtyre narrativave, ku Rusia përpiqet të pengojë integrimin e tyre me Perëndimin dhe të pozicionohet si mbrojtëse e vërtetë. Ndikimi rus mbështetet në lidhjet me Kishën Ortodokse dhe aspektin politik.<sup>135</sup>

---

<sup>128</sup> Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

<sup>129</sup> Teoria thotë se, popullsia e bardhë evropiane në përgjithësi po zëvendësohet demografikisht dhe kulturalisht nga popuj jo të bardhë, veçanërisht nga myslimanët. (<https://www.britannica.com/topic/replacement-theory>)

<sup>130</sup> Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.

<sup>131</sup> Intervistë me Jeta Loshaj, 14 tetor 2024.

<sup>132</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>133</sup> Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

<sup>134</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>135</sup> Intervistë me Agon Maliqi, 21 shtator 2024.



Narrativat e sotme theksojnë lidhjen mes sllavëve dhe ortodoksëve, duke forcuar ndikimin e tyre, ndërsa Rusia, me rolin e saj “kryesor” në krijimin e shteteve sllave ortodokse në Ballkan, vazhdon të ndikojë në marrëdhëniet kulturore dhe politike të rajonit.<sup>136</sup> Roli destabilizues i ortodoksisë ruse është një pjesë thelbësore e politikës së fuqisë së butë të Federatës Ruse, duke shërbyer si mjet për forcimin e lidhjeve me vendet e Ballkanit dhe për promovimin e narrativeve që favorizojnë interesat ruse, duke e shndërruar ortodoksinë në një instrument për të forcuar pozitat e saj në këtë zonë.<sup>137</sup>

Serbia po përdor ndikimin dhe mbështetjen e Rusisë në organizatat ndërkombëtare për të ushtruar presion mbi disa vende në lidhje me pavarësinë e Kosovës.<sup>138</sup> Mungesa e një narrative të caktuar në lidhje me luftën e vitit 1998–1999<sup>139</sup> dhe mungesa e grupeve punuese për Rusinë dhe Serbinë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës<sup>140</sup> krijojnë një boshllëk në ndikimin e narrativave të tjerëve.

---

<sup>136</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

<sup>137</sup> Kateryna Shymkevych (2024): Russia’s influence in the Balkans: challenges for supporting Ukraine in countering Russian armed aggression. Në Geopolitics Research Network.

<sup>138</sup> Intervistë me Kateryna Shymkevych, 23 tetor 2024.

<sup>139</sup> Intervistë me Jeta Loshaj, 14 tetor 2024.

<sup>140</sup> Intervistë me Lulzim Peci, 11 tetor 2024.

# Konkluzione

Raporti thekson se narrativat e dezinformimit ruse tentojnë krijimin e dyshimeve mbi legjitimitetin e shtetësisë së Kosovës dhe në përhapjen e ideve që nxisin tensione sociale dhe politike në rajon. Këto narrativa, duke u mbështetur në mesazhe anti-perëndimore dhe duke përdorur Kosovën si pretekst synojnë që të ndikojnë në mendimin publik dhe qëndrimet e disa shteteve të Evropës që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Kjo situatë paraqet një sfidë serioze për Kosovën, sidomos në kontekstin e luftës në Ukrainë, ku Rusia përpiqet të justifikojë veprimet e saj duke krahasuar situatat në të dyja vendet, duke bërë përpjekje të zhvlerësojë kështu mbështetje ndërkombëtare për shtetin e Kosovës.

Megjithatë, raporti vë në dukje se aktualisht Kosova nuk ka një strategji të qartë për të kundërshtuar këto narrativa dezinformuese. Mungesa e një plani të koordinuar për të adresuar këto informacione të gabuara e bën Kosovën më të prekshme ndaj sulmeve të tilla, duke rritur ndjeshmërinë e publikut ndaj këtyre mesazheve. Kjo kërkon një angazhim të rritur nga institucionet kosovare për të zhvilluar mekanizma efektivë të komunikimit dhe për të forcuar besimin e qytetarëve në informacionin zyrtar.

Gjithashtu duhet theksuar rëndësia e bashkëpunimit me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në përpjekjet për të kundërshtuar narrativat e dezinformimit. Kjo është e rëndësishme jo vetëm për të forcuar pozitat e Kosovës në arenën ndërkombëtare, por edhe për të siguruar mbështetje përmes burimeve dhe ekspertizës që këto institucione ofrojnë. Bashkëpunimi strategjik me aktorë të tjerë ndërkombëtarë mund të ndihmojë në krijimin e një narrativi të përbashkët që nxit stabilitetin dhe promovon vlerat demokratike në rajon.

Në përfundim, Kosova duhet të angazhohet në një përpjekje aktive për të adresuar dhe sfiduar narrativat e dezinformimit ruse. Kjo përfshin përmirësimin e komunikimit publik, angazhimin e ekspertëve në fushën e komunikimit dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për dezinformimin. Këto hapa janë të domosdoshëm për të ruajtur stabilitetin e brendshëm dhe për të forcuar pozitat e Kosovës në një ambient global gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të ndjeshëm ndaj dezinformimit.

Kultivimi i gjykimit kritik të qytetarët kërkon një qasje të integruar që përfshin sensibilizimin përmes fushatave informuese, trajnimeve dhe avokimit në format e ndryshme, si dhe përfshirjen e edukimit medial në kurrikulat shkollore. Kjo strategji e dyfishtë synon të zhvillojë aftësitë kritike të individëve për të analizuar informacionin dhe për të zbuluar burimet e besueshme, duke i fuqizuar ata të dallojnë faktet nga keqinformimi dhe propaganda. Fushatat sensibilizuese kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit publik, ndërsa edukimi medial i qëndrueshëm në shkolla siguron formimin e brezave të rinj me aftësi të mendimit kritik të zhvilluara që në moshë të hershme.





